



safejournalists.net

# MAQEDONIA E VERIUT

## Treguesit e nivelit të lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve në vitin 2021





**MAQEDONIA E  
VERIUT  
Treguesit e nivelit  
të lirisë së mediave  
dhe sigurisë së  
gazetarëve në  
vitin 2021**

**Autorë  
Milan Spirovski  
Biljana Nasteska Kalanoska**

## Titulli

Maqedonia e Veriut: Treguesit e nivelit të lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve në vitin 2021

## Botues

Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë  
Skopje 2022



## Autorë

Milan Spirovski dhe Biljana Nasteska Kalanoska

Përkthyes në gjuhën shqipe

Kristina Naceva

## Proofreading

Maja Katarova Apostolova

## Recensente

Marina Tuneva

## Fotografia e ballinës

Andrija Vukelić

## Dizajni

comma.rs

## Tirazhi

50

Ky publikim është përpiluar me ndihmën financiare të Bashkimit Evropian dhe Balkan Trust for Democracy – projekt i German Marshall të Shteteve të Bashkuara dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se i pasqyron qëndrimet e Bashkimit Evropian dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë Balkan Trust for Democracy, German Marshall Fund të Shteteve të Bashkuara ose partnerëve të saj.



 **Norway**

**B | T | D** The Balkan Trust  
for Democracy

A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND

<b>Hyrje</b>	<b>7</b>		
<b>A Mbrojtja juridike</b>	<b>9</b>		
A1 Garancitë juridike për lirinë e mediave dhe gazetarëve dhe zbatimimi i tyre në praktikë	9	B3 Pavarësia redaktuese në radiodifuzerin publik	21
A2 Efekti i ligjeve për shpifje mbi gazetarët	13	B4 Pavarësia redaktoriale në sektorin jofitimprurës	22
A3 Mbrojtja e pluralizmit politik në media	14	B5 Liria e gazetarëve në procesin e prodhimit të lajmeve	23
A4 Liria e punës dhe e bashkimit të gazetarëve	15	B6 Pozita ekonomike e gazetarëve	23
A5 Mbrojtja e burimeve të informacioneve	16	<b>C Siguria e gazetarëve</b>	<b>25</b>
A6 E drejta e qasjes në informata	17	C1 Statistikë për sigurinë dhe për mosndëshkimin	25
<b>B Pozita e gazetarëve në redaksi</b>	<b>19</b>	C2 Sjellja e institucioneve shtetërore dhe e aktorëve politikë ndaj mbrojtjes së gazetarëve	27
B1 Kufizimet ekonomike në punën e gazetarisë	19	C3 Sjellja e sistemit gjyqësor civil dhe penal ndaj kërcënimeve dhe dhunës mbi gazetarët	29
B2 Pavarësia redaktoriale në mediat private	20	<b>Konkluzione dhe rekomandime</b>	<b>33</b>

# Pasqyrim dhe përmbledhje e projektit

Shoqatat e gazetarëve nga vendet e Ballkanit Perëndimor, me mbështetjen e Komisionit Evropian<sup>1</sup>, kanë krijuar një platformë të përbashkët [Safejournalists.net](https://www.safejournalists.net) për të monitoruar ndryshimet në legjislacionin dhe praktikën e vendeve të tyre dhe për t'u përfshirë në aktivitete të ndryshme për përfaqësim, të orientuara në avancimin e mjedisit politik, legjislativ dhe institucional në të cilin punojnë gazetarët dhe mediat. Duke filluar nga viti 2020, anëtarët e platformës e monitorojnë situatën në shtatë shtete (Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Kroaci, Maqedoni e Veriut, Mal të Zi, Kosovë<sup>2</sup> dhe Serbi). Çdo vit, vlerësimi i situatës kryhet bazuar në metoda të standardizuara të mbledhjes dhe analizës së të dhënave<sup>3</sup>, ndërsa fokusi i kërkimit të përfaqësimit është në ndryshimet si në mjedisin tradicional mediatik ashtu edhe në atë të mediave online në Ballkanin Perëndimor.

- 
- <sup>1</sup> Në dhjetor të vitit 2019, Komisioni Evropian e miratoi projektin tre-vjeçar [Safejournalists.net](https://www.safejournalists.net), i cili synon të forcojë shoqatat kombëtare të gazetarëve në Ballkanin Perëndimor për t'u bërë aktorë të pavarur të suksesshëm dhe të përgjegjshëm në përfaqësimin për zbatimin e standardeve të BE-së në fushën e lirisë së mediave, me një synim afatgjatë për të avancuar të drejtën e qytetarëve për zgjedhje të informuar. Ky aksion është një vazhdim i projektit të mëparshëm (Platforma Rajonale për Ballkanin Perëndimor për Përfaqësimin për Lirinë e Mediave dhe Sigurinë e Gazetarëve) dhe bazohet në njohuritë dhe përvojën e ndërtuar në periudhën 2016-2018. Aksioni mbështetet nga Programi për organizatat e shoqërisë civile dhe media 2020-2022, Mbështetje për rjetet tematike rajonale të organizatave të shoqërisë civile.
  - <sup>2</sup> Ky emër është pa prejjudikuar për statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe me Mendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për Deklaratën dhe Pavarësinë e Kosovës.
  - <sup>3</sup> Edicioni i parë i Metodologjisë për këtë hulumtim për përfaqësim u zhvillua në vitin 2016 dhe u kompletua gjatë viteve për të pasqyruar situatën në vendet e Ballkanit Perëndimor. Hulumtimi i përfaqësimit e dizajnuan dhe e koordinojnë Snezhana Terpevska dhe Igor Micevski, hulumtues në Institutin për Hulumtim të Zhvillimit Social RESIS nga Maqedonia e Veriut. ([www.resis.mk](http://www.resis.mk)).

# Shënim metodologjik

Metodologjia e hulumtimit përbëhet nga tre grupe treguesish të zhvilluar bazuar në një analizë sistematike të udhëzimeve të ndryshme të prodhuara nga organizatat ndërkombëtare relevante. Gjatë viteve të fundit, treguesit cilësorë të zhvilluar fillimisht janë rafinuar për të mbuluar kontekstin karakteristik socio-politik të Ballkanit Perëndimor dhe nevojat dhe interesat specifike të gazetarëve në të shtatë vendet.

U aplikuan një sërë metodash të ndryshme hulumtuese për grumbullimin dhe analizën e të dhënave me qëllim që t'u përgjigjet pyetjeve indikatorë që ndërlidhen me secilin indikator specifik:

- Pasqyrë e studimeve, analizave, raporteve kërkimore, dokumenteve të politikave, strategjive dhe dokumenteve të tjera;
- Analizë cilësore e dokumenteve ligjore;
- Kërkim dhe analizë e informacioneve të publikuara në ueb faqet e institucioneve publike dhe organizatave dhe organeve të tjera;
- Kërkim dhe analiza e kumtesave për shtyp, njoftimeve dhe informacioneve të tjera të prodhuara nga organizatat profesionale;
- Të dhëna sekondare të mbledhura nga shoqatat e gazetarëve;
- Intervista të thelluara me ekspertë, gazetarë, krijues të politikave etj.;
- Fokus grupe me gazetarë dhe
- Anketa me gazetarë (në disa prej vendeve).

Në nivel nacional, shoqatat e gazetarëve nominuan hulumtues kombëtarë për të kryer mbledhjen e të dhënave dhe për të shkruar raporte narrative, të cilat më pas u rishikuan nga ekspertë të emëruar kombëtarë dhe studiues kryesorë. Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë i nominoi Milan Spirovskin dhe Biljana Nasteska Kalanoska si hulumtues kombëtarë, kurse Marina Tunevën si eksperte media-tike për të kryer recensimin e raportit.

Tabela 1: Treguesit e nivelit të lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve

A. Mbrojtja juridike	B. Pozita e gazetarëve në redaksi	C. Siguria e gazetarëve
A.1 Garancitë juridike për lirinë e mediave dhe zbatimimi i tyre në praktikë	B.1 Kufizimet ekonomike të lirisë së gazetarëve	C.1 Statistika për sigurinë dhe mosndëshkimin
A.2 Efekti i ligjeve për shpifjen mbi gazetarët	B.2 Pavarësia redaktoriale në mediat private	C.2 Sjellja e institucioneve shtetërore dhe e politikanëve ndaj mbrojtjes së gazetarëve
A.3 Mbrojtja e pluralizmit politik në media	B.3 Pavarësia redaktoriale në radiodifuzerin publik	C.3 Sjellja e sistemit gjyqësor penal dhe civil ndaj kërcënimeve dhe dhunës mbi gazetarët
A.4 Liria e punës dhe e bashkimit të gazetarëve	B.4 Pavarësia redaktoriale në sektorin jofitimprurës	
A.5 Mbrojtja ligjore e burimeve gazetareske	B.5 Liria e gazetarëve në procesin e prodhimit të lajmeve	
A.6 Mbrojtja e të drejtës për qasje në informata	B.6 Pozita ekonomike e gazetarëve	

Lista e shkurtesave

KSHZ	Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve
ASHMAA	Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele
RTM	Radiotelevizioni i Maqedonisë
SHGM	Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë
SPGPM	Sindikata e Pavarur e Gazetarëve dhe Punonjësve Mediatik
IMM	Instituti Maqedonas i Mediave
KEMM	Këshilli për Etikë në Media
RMV	Republika e Maqedonisë së Veriut
MIA	Agjencia Informative Mediatike
IRL	Laboratori Hulumtues i Reporterëve



Akti më i lartë juridik i Republikës së Maqedonisë së Veriut është Kushtetuta, e cila e definon shtetin si demokraci parlamentare me ndarjen e pushtetit në legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor. Liria, barazia, sundimi i së drejtës dhe respektimi i të drejtave të njeriut të të gjithë qytetarëve janë vlerat më të larta në rendin kushtetues të vendit. Si rregull, pas çdo zgjedhjeje parlamentare, qeveria formohet nga partitë politike të bllokut maqedonas dhe shqiptar që kanë fituar më së shumti vota në zgjedhje. Në vitin 2021, pas gati 20 vitesh, në Republikën e Maqedonisë së Veriut është kryer Regjistrimi i popullsisë dhe i amvisërive, në të cilin janë regjistruar gjithsej 1.832.696 persona dhe 568.175 amvisëri. Duke pasur parasysh faktin se rezultatet zyrtare të detajuara të regjistrimit nuk ishin publikuar ende derisa po përgatitej ky raport, këtu janë renditur të dhënat nga regjistrimi i fundit i Regjistrimit të kryer në vend në vitin 2002. Popullsia e përgjithshme në atë kohë ishte 2,022,547 banorë, me përkatësi të ndryshme etnike: maqedonas 65,17%, shqiptarë 25,17%, turq 3,85%, romë 2,66%, serbë 1,78%, dhe një përqindje më e vogël e pjesëtarëve të bashkësive të tjera etnike (boshnjakë, vllleh, bullgarë, malazezët etj.).

Në zgjedhjet e fundit lokale në tetor të vitit 2021 ndodhën ndryshime të mëdha në skenën politike: partia opozita VMRO-DPMNE-ja fitoi shumë më shumë poste kryetar komunash dhe ulëse në Këshillat Komunalë sesa LSDM-ja në pushtet<sup>4</sup>. Si rezultat i dështimit të zgjedhjeve, lideri i LSDM-së dhe kryeministër aktual dha dorëheqjen e më pas vijuan zgjedhjet brenda partiake dhe zgjedhja e Qeverisë së re. Reformat

4 KSHZ, "Kumtesë për rezultatet nga zgjedhjet lokale në Republikën e Maqedonisë së Veriut", viti 2021. <https://bit.ly/3w9KmHi>

e shumëpritura mediatike për shkak të këtyre proceseve u shtynë edhe më tej, nuk u zgjodh as përbërja e re e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe audiovizuale e as Këshilli programor i Radio Televizionit të Maqedonisë. U prolongua edhe miratimi i ndryshimeve dhe plotësimeve në Kodin Penal<sup>5</sup>, të cilat parashikojnë mbrojtje sistematike të gazetarëve në rast të shkeljes së të drejtave dhe lirive të tyre, si dhe janë shtyrë edhe ndryshimet në Ligjin për përgjegjësinë civile për shpifje dhe fyerje<sup>6</sup>, me të cilat ulet lartësia e kompensimit për dëmin jomaterial për gazetarët e të cilat kanë hyrë në procedurë parlamentare që në muajin gusht.

Dëmi përfundimtar nga pandemia e shkaktuar nga Covid-19 është ende i vështirë për t'u vlerësuar, por sipas vlerësimeve të hershme, rënia e bruto prodhimit të vendit po lëvizë prej 4 deri në 6 për qind. Masat e përkohshme qeveritare për mbështetje (kompensime për të punësuarit, lirimi nga kontributet tatimore dhe kontributet për sigurim social etj.) patën një ndikim të rëndësishëm fiskal, por vetëm pjesërisht e zbutën gjendjen e vështirë në të cilën ndodhej ekonomia. Megjithatë viti 2021 ishte veçanërisht i vështirë për mediat për shkak të rënies së të ardhurave nga reklamat, Qeveria dhe Rregullatori i mediave në një farë mase i zbutën efektet negative të krizës ekonomike nëpërmjet formave të ndryshme të subvencioneve direkte dhe indirekte. Një burim shtesë të ardhurash për mediat ishin mjetet e reklamimit politik në periudhën e fushatës zgjedhore, por ekziston një shqetësim i përgjithshëm se kjo cenon pavarësinë e politikës redaktuese.

Analiza<sup>7</sup> e Rregullatorit tregojnë se buxhetet vitet e kaluara po zvogëlohen, kurse dhjetëra radiodifuzerë ndërprejnë së funksionuari në vitin e kaluar. Mediat mezi po mbijetojnë në një treg të vogël mediatik por të mbushur plot. Në sektorin e televizionit ekziston një servis publik (me 5 kanale televizive) dhe 45 kanale televizive private. Platforma dominuese për marrjen e programeve televizive është platforma kabllore (61.7%), pastaj IPTV (23.7%), DVBT (9.9%), interneti (4.4%) dhe platforma satelitore (3.1%). Në tregun e radios ekziston servisi publik (me 3 kanale), 67 radiostacione private dhe 4 stacione jofitimprurëse. Në sektorin e mediave të shtypura botohen: 5 gazeta ditore, 2 revista javore dhe rreth 11 botime të tjera. Ekzistojnë gjithashtu midis 150 dhe 200 media digjitale vendase. Teknologjitë e reja e kanë ndryshuar plotësisht kohën e lirë të audiencës. Pothuajse 80 për qind e audiencës informohet në internet.

Gazetarët dhe punonjësit mediatik mbeten ekonomikisht të pasigurt dhe pothuajse nuk ka kontrata kolektive për të mbrojtur të drejtat e tyre të punës. Edhe në vitin 2021, pati raste të kërcënimeve serioze online ndaj gazetarëve, por institucionet nuk ishin mjaftueshëm efektive në zbulimin dhe ndëshkimin e sulmuesve. Mirëpo, duhet theksuar se një nga rastet (koment me urrejtje i shkruar në faqen e Facebook të SHGM-së) ka përfunduar me aktgjykim me dënim me burg me kusht për autorin e kësaj veprë.<sup>8</sup>

5 Kuvendi i RMV, Propozim-Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Penal, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Qasur prej dt. 7.1.2022. [Detale për materiale \(sobranie.mk\)](#).

6 Kuvendi i RMV, Propozim-Ligj për përgjegjësi penale për shpifje dhe fyerje, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Qasur prej dt. 7.1.2022 [Detale për materiale \(sobranie.mk\)](#).

7 ASHMAA, "Analiza e tregut të shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuale për vitin 2020". Qasur prej dt. 11.1.2022. <https://bit.ly/3tPzmyZ>

8 SHGM, "Dënim me kusht për koment me gjuhë të urrejtjes shkruar në faqen e SHGM-së në Facebook". Qasur më dt. 29.12.2021. <https://bit.ly/3uK7bRg>

### **A1 Garancitë juridike për lirinë e mediave dhe gazetarëve dhe zbatimi i tyre në praktikë**

**A është e garantuar e drejta e lirisë së shprehjes dhe informimit? A përfshin kjo edhe akses në internet? A po zbatohen në praktikë këto garanci juridike?**

Garancitë themelore për lirinë e shprehjes dhe pavarësinë e mediave, përveçse në Kushtetutë, janë inkorporuar edhe në ligjet për media dhe në disa ligje të tjera. Të gjitha këto ligje mbulojnë edhe të drejtën e aksesit në internet, gjegjësisht nuk ka ndonjë legjislacion të veçantë që rregullon vetëm internetin. Vlerësimi për zbatimin e këtyre garancive është pozitiv, para së gjithash për faktin se në krahasim me vitin 2020, numri i kërcënimeve dhe sulmeve të regjistruara ndaj gazetarëve dhe mediave është zvogëluar për më shumë se përgjysmë. Megjithatë, edhe përkundër rënies së numrit të sulmeve, gazetarët dhe punonjësit e mediatik vazhdojnë të ndihen të pasigurt për shkak të mosndëshkimit, veçanërisht nga rastet e viteve të mëparshme.<sup>9</sup> Sipas Indeksit<sup>10</sup> të Reporterëve pa Kufij, Maqedonia e Veriut, Raport i Reporterëve pa Kufij për vitin 2021. Maqedonia e Veriut ishte dy vende më lart në këtë listë dhe u rendit në vendin e 90-të nga gjithsej 180 vende

9 Milan Spirovski dhe Verçe Todorovska Kostovska, "Maqedonia e Veriut – Tregues për nivelin e lirisë së mediave dhe për sigurinë e gazetarëve", Shkup: SHGM, viti 2020. Qasur prej dt. 23.12.2021. <https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2021/08/MK-MK-2020.pdf>

10 Reporterët pa Kufij, Maqedonia e Veriut, Raport i Reporterëve pa Kufij për vitin 2021. Qasur prej dt. 11.1.2022. <https://rsf.org/en/north-macedonia>

në botë. Një nga problemet kryesore të theksuara nga Raporti i Reporterëve pa Kufi është vazhdimi i kulturës së mosndëshkimit për sulmet ndaj gazetarëve: "Situata me mediat është përkeqësuar, përfaqësues të lartë qeveritarë kanë vazhduar të kërcënojnë dhe ofendojnë mediat, dhe ngacmimet dhe sulmet verbale janë shtuar ndaj gazetarëve në rrjetet sociale."

Edhe në vitin 2021 Kuvendi nuk i realizoi aktivitetet e paralajmëruara për zgjedhjen dhe emërimin e organeve vendimmarrëse në RTM dhe Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (ASHMAA), edhe përkundër kërkesave nga shoqatat esnafe. Ata, që fillim të vitit 2021 kërkuar publikisht<sup>11</sup> që zgjedhja dhe emërimi i këtyre organeve të votohej me dy të tretat e shumicës në vend të shumicës së thjeshtë në Parlament.

### A u miratuan ligjet për media dhe ligjet tjera të rëndësishme për gazetarët përmes proceseve transparente dhe gjithëpërfshirëse në konsultim me organizatat profesionale relevante?

Qeveria në mënyrë jotransparente ka iniciuar ndryshime në Ligjin për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale me qëllim rikthimin e reklamave shtetërore, por propozimi u tërhoq. Organizatat mediatike i kundërshtuan ashpër ndryshimet e propozuara në ligj, me arsytim se kjo do të forconte më tej lidhjen financiare-klienteliste ndërmjet mediave private dhe pushtetit.

Miratimi i paralajmëruar i ndryshimeve të Ligjit për përgjegjësi civile për shpifje dhe fyerje dhe të ndryshimeve dhe plotësimeve në Kodin Penal, në drejtim të mbrojtjes më të madhe të gazetarëve dhe punonjësve mediatik nuk ndodhi as në vitin 2021. Edhe pse në vitin 2020, SHGM-ja ishte e përfshirë dhe e konsultuar gjatë përgatitjes së ndryshimeve të këtyre dy ligjeve, megjithatë, vërejtja e saj thelbësore është se procesi i ndryshimeve në këto ligje ishte i ngadaltë dhe pa një kornizë kohore të përcaktuar për miratim dhe për zbatim.<sup>12</sup>

### A janë përpjekur autoritetet të vendosin regjistrimin ose kushte të tjera më të rrepta për themelimin e mediave të shtypura apo online? A shkojnë kërkesat përtej regjistrimit të zakonshëm afarist dhe tatimor?

Nuk ekzistojnë kërkesa të veçanta për krijimin e mediave të shtypura apo online në vend, me përjashtim të procedurës së zakonshme të regjistrimit të mediumit si subjekt afarist pranë organeve kompetente. Për mediat e shtypura vlejnë detyrimet minimale të përcaktuara në Ligjin për media, për sa i përket kushteve themelore për botim, detyrimin për funksionimin e publikut, mbrojtjen e burimeve të informacionit, mbrojtjen e të miturve, ndalimin e gjuhës së urrejtjes dhe nxitjes për dhunë dhe disa detyrime të tjera që lidhen me organizimin dhe aktet e brendshme të botuesve. Përmbajtja e mediave online nuk është fare subjekt i legjislacionit mediatik, sepse në komunitetin mediatik mbisundon mendimi se ato duhet të jenë subjekt i vetë-rregullimit. Në drejtim të përforcimit të vetë-rregullimit, si dhe me qëllim të ngritjes së nivelit të profesionalizmit dhe standardeve në gazetarinë online, SHGM-ja dhe Këshilli për Etikë në Media në Maqedoni (KEMM) vazhduan me promovimin e Regjistrimit të Mediave Online,<sup>13</sup> i cili ishte themeluar në dhjetor të vitit 2019 dhe që u nënvizua edhe në Raportin e Komisionit Evropian<sup>14</sup> si një praktikë e mirë. Numri i anëtarëve të regjistruar në Regjistrin e Mediave Profesionale Online në vitin 2020 ishte 138, kurse e në fund të vitit 2021 u rrit në gjithsej 152 anëtarë.

Në prill të vitit 2021, SHGM-ja, KEMM-i dhe agregatori [Time.mk](https://time.mk)<sup>15</sup> ranë dakord që mediat online nga Regjistrimi i Mediave Profesionale Online [Promedia.mk](https://promedia.mk) të nënvizohen qartë në faqen e agregatorit (<https://time.mk/blue>), në mënyrë që të identifikohen mediat online profesionale dhe etike. Vetë-rregullimi i hapësirës mediatike me këtë merr një cilësi të re, një hap plus për profesionalizimin e sferës online, si një nga mjetet për rritjen e edukimit mediatik në vend, por edhe për mbrojtjen e qytetarëve nga informacionet që nuk përpunohen sipas Kodit të Gazetarëve dhe standardeve të profesionit të gazetarisë. Proces i anëtarësimit në Regjistrin mbetet i hapur për mediat që i plotësojnë kriteret e listuara në faqen e KEMM-it: <https://www.semm.mk/chlenstvo/pravila-za-chlenstvo>.

11 SHGM, SPGPM, IMM dhe KEMM: "Zgjedhja e organeve në RTM dhe ASHMAA me shumicë të thjeshtë është e rrezikshme", Shkup, 2021. Qasur prej dt. 12.12.2021. <https://bit.ly/3ITNgV8>

12 Edhe pse ndryshimet në Ligjin për përgjegjësi civile për shpifje dhe fyerje ishin parashikuar që në "Planin 18" të vitit 2018, Grupi i Punës i Ministrisë së Drejtësisë që u formua në qershor të vitit 2019 ka filluar me punë madje në fund të vitit 2020.

13 Regjistrimi i mediave profesionale online – Promedia. [www.promedia.mk](https://www.promedia.mk)

14 Komisioni Evropian, "Raport i Komisionit Evropian për Maqedoninë e Veriut për vitin 2021", Strasburg, 2021. Qasur prej dt. 25.1.2021. <https://www.sep.gov.mk/data/file/Preqovori/Nortin-Macedonia-Report-2021-%D0%9C%D0%9A2.pdf>

15 SHGM, KEMM dhe [time.mk](https://time.mk), "Regjistrimi i online mediave profesionale në [time.mk](https://time.mk)", Shkup, 2021. Qasur prej dt. 7.2.2022. <https://bit.ly/3qP46Oy>

## A janë përpjekur autoritetet të kufizojnë të drejtën e aksesit në internet ose të kërkojnë bllokimin ose filtrimin e përmbajtjeve në internet?

Ashtu sikurse vitin e kaluar, edhe në vitin 2021 nuk është bërë asnjë përpjekje nga Qeveria apo ndonjë organ tjetër shtetëror për të bllokuar apo filtruar përmbajtje interneti. Vlerësimi është se e drejta e lirisë së shprehjes në hapësirën e internetit shfrytëzohet lirisht nga qytetarët, mediat dhe organizatat e tjera.

## A e kryen Organi rregullator misionin dhe funksionet e tij në mënyrë të pavarur dhe jodiskriminuese? Nëse procesi i licencimit dhe rregulloret e tjera për transmetim zbatohen në mënyrë korrekte dhe neutrale?

Në vitin 2021, Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM) nuk e kritikoi funksionimin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe audiovizuale (ASHMAA). Puna e kësaj Agjencie mund të vlerësohet si e pavarur dhe objektive, pa trajtim diskriminues të disa mediave audiovizuale. ASHMAA në vitin e kaluar, në mënyrë korrekte dhe të paanshme ka monitoruar zgjedhjet lokale. Edhe këtë vit anëtarët e rinj të Këshillit të ASHMAA nuk u zgjodhën për shkak të mosmarrëveshjeve politike mes partive në Kuvend, gjë që tregon se partitë politike ende nuk kanë ndërmend të heqin dorë nga ndikimi i tyre në Organin rregullator.

## A ekzistojnë dispozita ligjore që kanë të bëjnë me reklamën shtetërore në media dhe a keqpërdoren ato për ndikim politik në politikën e tyre redaktuese? A bëhet shpërndarja e fondeve shtetërore në mënyrë transparente, të drejtë dhe jodiskriminuese? A i publikojnë rregullisht institucionet shtetërore të dhëna për shumat e akorduara për media të ndryshme?

Reklamimi shtetëror është i ndaluar me ndryshimet në nenin 102 të Ligjit për shërbimet mediatike audio dhe audiovizuale nga dhjetori i vitit 2018 dhe që në vitin 2015 Qeveria miratoi vendim për moratoriumin e plotë të reklamave shtetërore, me kërkesë të SHGM-së dhe sektorit joqeveritar. Në vitet e kaluara, ky vendim u respektua, por në nivel lokal, komunat dhe ndërmarrjet publike ende ndanin mjete nga buxhetet për mediat private lokale - gjë që në thelb e cenoi pozicionin e tyre të pavarur. Disa humltime të caktuara mediatike<sup>16</sup> konfirmojnë se një numër i komunave edhe deri më tani nuk e kanë respektuar re-

strikcionin ligjor dhe kanë nënshkruar lloje të ndryshme kontratash me transmetuesit për sigurimin e fondeve nga buxhetet lokale për mediat, por të mos shkelin ligjin.

Në maj të vitit 2021, Qeveria paralajmëroi mundësinë e heqjes së ndalimit të reklamimit me fonde publike në mediat private audiovizuale, gjë që u kritikua ashpër nga SHGM-ja dhe organizata të tjera gazetareske dhe mediatike<sup>17</sup>, pasi mund të rrezikonte pavarësinë redaktuese të mediave, të prishte më tej tregun mediatik tashmë të brishtë dhe të rrit klientelizmin. Qëndrimi i SHGM-së është se duhet të ndihmohen mediat, sidomos kur kriza financiare është në rritje, por duhet të jetë në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese. SHGM-ja përkrahu idenë e krijimit të një Fondi të Mediave me kriteret të përcaktuara qartë, ku çdo media të mund të aplikonte për projekte me interes publik.<sup>18</sup>

Për të reduktuar pasojat ekonomike të pandemisë, në prill të vitit 2021 Qeveria miratoi disa paketa masash ekonomike<sup>19</sup>, ndër të cilat, nëpërmjet Bankës për Zhvillim, u sigurua një linjë kredie pa interes prej një milion eurosh për të mbështetur mediat që transmetojnë programe radiotelevizive. Gjithashtu, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale miratoi vendim<sup>20</sup> për të pezulluar të gjitha procedurat e nisura për marrjen e licencës në bazë të tarifës vjetore të papaguar për transmetimin radioteleviziv. Në të njëjtën kohë, Rregullatori vendosi të mos nisë procedura të reja për heqjen e licencave për shkak të mospagesës së tarifës së licencës për vitin 2021. Të gjithë radiodifuzerëve që kanë bërë pagesën e plotë ose të pjesshme të tarifës së licencës për transmetimet radiotelevizive në vitin 2021, Agjencia vendosi t'u akthejë fondet më së voni deri më 13 mars të vitit 2021.

## A ekzistojnë subvencione apo fonde mediatike për prodhimin e përmbajtjeve mediatike me interes publik dhe si zbatohen ato në praktikë?

Në vitin 2021, Qeveria miratoi Programin për mbështetje për shtyp dhe distribuim të mediave të shtypura në vlerë prej 30 milionë denarë, që është dukshëm shumë më e ulët në krahasim me vitet e kaluara.<sup>21</sup> Programi zbatohet për të katërtin vit radhazi, me qëllim mbështet-

<sup>16</sup> BIRN Maqedoni, "Fushatat qeveritare një hap prapa në media", Shkup, 2021. Qasur prej dt. 11.12.2021. <https://bit.ly/3tRoac6>

<sup>17</sup> SHGM, SPGPM, KEMM dhe IMM, "Nuk na duhet reprizë e fushatave të paguara publike në media", Shkup, 2021. Qasur prej dt. 9.12.2022. <https://bit.ly/3BXrXiu>

<sup>18</sup> SHGM, "Fushatat publike në media duhet të jenë falas", Shkup: 2021. Qasur prej dt. 26.2.2022. <https://bit.ly/3w8Ayfn>

<sup>19</sup> Qeveria e RMV, Kumtesë për ndarjen e paketës së gjashtë të masave ekonomike, 20.4.2021, <https://vlada.mk/node/24947?ln=mk>

<sup>20</sup> ASHMA, "Mbështetje financiare për kompensimin e mjeteve për licencë për TV dhe RA transmetim", Shkup, 2021. <https://bit.ly/3Mbyld6>

<sup>21</sup> Qeveria e RMV, "Programi për mbështetjen për shtypin dhe distribuimi e mediave të shtypura për vitin 2021", Shkup, 2021. Qasur prej dt. 10.1.2021. <https://bit.ly/3994oKb>

jen e mediave të shtypura me karakter të përgjithshëm dhe informativ. Për ndarjen e mjeteve vendos një komision, ku përveç përfaqësuesve të institucioneve kompetente marrin pjesë edhe nga një përfaqësues të Asociacionit për Mbrojtjen e Mediave Kombëtare të Shtypura dhe të SHGM-së. Komisioni për vitin 2021 ka marrë vendim në bazë të kriterëve të përcaktuara qartë, dhe shumica e mbështetjes së aprovuar është përcaktuar në bazë të faturave të dorëzuara për vitin kalendarik 2020. Megjithatë, nuk ka asnjë mekanizëm për të kontrolluar se si janë përdorur mjetet e ndara.

### Cilat janë mekanizmat për financimin e mediave në gjuhët e bashkësive?

Përveç radio programeve dhe Tv-programeve në gjuhët e bashkësive etnike, në kuadër të servisit publik radiodifuziv nuk ekzistojnë mekanizma të tjerë për mbështetjen financiare të mediave në gjuhët e bashkësive të ndryshme etnike. Në fund të vitit 2021, në sektorin e radiodifuzionit funksiononin 19 televizione dhe 13 radio që transmetonin programe në njërin nga gjuhët e bashkësive etnike që jetojnë në Maqedoninë e Veriut.<sup>22</sup> Shumica e këtyre radiodifuzerëve privatë transmetojnë në gjuhën shqipe, ndërsa komunitetet më të vogla etnike (turqit, romët, vllahët, serbët dhe boshnjakët) pothuajse nuk kanë qasje në programet televizive dhe radio private. Mungon një politikë e përshtatshme mediatike për zgjidhjen e këtij problemi, që reflektohet në tablonë e përgjithshme pluraliste në media në RMV.

### A janë të garantuara dhe të mbrojtura në mënyrë efektive pavarësia dhe autonomia e servisit radiodifuziv publik? A siguron korniza e financimit pavarësinë dhe funksionimin e tij të qëndrueshëm? A e përfaqësojnë organet mbikëqyrëse shoqërinë në tërësi?

Reforma në servisin publik ishte një nga çështjet kyçe në kuadër të kërkesës së sektorit joqeveritar për zbatimin e reformave gjithëpërfshirëse në sferën mediatike në vend. Kjo kërkesë lidhej, para së gjithash, me rritjen e buxhetit për këtë medium, si dhe me nevojën për sigurimin e pavarësisë së tij më të madhe duke filluar nga zgjedhja e anëtarëve të rinj të Këshillit programor të Radio Televizionit të Maqedonisë (RTM). Financimi i RTM-së u ndryshua tërësisht në vitin 2018, kur nga taksa radiodifuzive (tarifa publike) kaloi në një përqindje fikse të Buxhetit të RMV-së, për të siguruar financim afatgjatë dhe të qëndrueshëm. Megjithatë, RTM-ja ende ballafaqohet me probleme financiare për shkak të borxheve të viteve të kaluara dhe për

faktin se Qeveria nuk i ka paguar mjetet në tërësi sipas dinamikës së parashikuar me ligj. Sipas përlogaritjeve të SHGM-së, RTM-ja në vitin 2021 ka pasur të ardhurat më të ulëta në tre vitet e fundit. Nga ana tjetër, obligimet programore të RTM-së madje janë rritur me hapjen e kanalit 24-orësh në gjuhën shqipe dhe shërbimet e reja tematike (kanali për fëmijë dhe sport).

*Reforma në servisin publik radiodifuziv është në një fazë të hershme dhe duhet t'i jepet prioritet në Kuvendin e RMV-së. Mjetet financiare të destinuara për mbështetjen financiare të funksionimit të rregullt që RTM i merr nga Buxheti i RMV-së, si mjete për financimin e veprimtarisë radiodifuzive janë planifikuar në vlerë prej 1.564.500.000 denarë ose 95,7 për qind nga gjithsej të hyrat e planifikuara. Kjo shumë është përcaktuar në bazë të informacioneve të disponueshme të ueb faqes së Ministrisë së Financave për të ardhurat totale të realizuara në nivel shtetëror gjatë tetë muajve të vitit 2021, dhe në përputhje me nenin 105 paragrafi 1 dhe nenin 45 të dispozitave kalimtare në fuqi në Ligjin për SHMAA, ku thuhet se, duke filluar nga viti 2021 e në vazhdim për financimin e veprimtarisë radiodifuzive, nga Buxheti i RMV-së duhet të ndahen mjete në vlerë prej 1 për qind të të hyrave totale të realizuara në vitin para vitit fiskal për të cilin përcaktohet shumica.<sup>23</sup>*

Organi që, në fakt, duhet të hartojë dhe zbatojë reformat në RTM është Këshilli Programor, por zgjedhja e anëtarëve të rinj, si një nga kërkesat kyçe për ngritjen e nivelit të pavarësisë së RTM-së, nuk ka ndodhur as në vitin 2020 as në vitin 2021. Në vend të kësaj, Kuvendi vendosi zgjatjen e mandatit të anëtarëve ekzistues, pa kryer një procedurë të re zgjedhore. Ky organ ka përgatitur draft-strategji për zhvillimin pesëvjeçar të RTM-së dhe ka zhvilluar konsultime, në të cilat propozimet dhe vërejtjet e tyre i kanë dhënë SHGM-ja dhe organizata dhe ekspertët të tjerë relevantë. Në konsultime u theksua se është pozitive që Këshilli Programor vendosi miratimin e një strategjie zhvillimore, por që duhet një përpunim serioz i këtij dokumenti.

Parlamenti Evropian u ka bërë thirrje autoriteteve të vendit të forcojnë reformat mediatike dhe të sigurojnë pavarësi më të madhe të servisit publik radiodifuziv. Në tekstin e Rezolutës u bëhet thirrje autoriteteve "të përshpejtojnë zbatimin e reformave sistematike mediatike, të cilat do të kontribuojnë në rigjallërimin e konkurrencës, rritjen e pavarësisë dhe kapacitetit të servisit publik radiodifuziv dhe Rregullatorit mediatik dhe të mbështesin gazetarinë hulumtuese"<sup>24</sup>.

22 Regjistri i radiodifuzerëve Tv dhe radio i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Qasur prej dt. 19 shkurt të vitit 2022. <https://avmu.mk/radiodifuzeri.mk/>

23 RTM, "Propozim-plani financiar i ndërmarrjes publike radiodifuzive Radio Televizioni i Maqedonisë për vitin 2022. Qasur prej dt. 14.2.2022. <https://bit.ly/36O8Jn>

24 European Parliament, "European Parliament resolution on March 25, 2021, on the 2019-2020 Commission Reports on North Macedonia (2019/2174(INII))", Strasbourg, 2021, p. 11. <https://bit.ly/3wRVzyc>

## A2 Efekti i ligjeve për shpifje mbi gazetarët

A janë dispozitat e ligjeve për shpifje shumë strikte dhe a i mbrojnë ato funksionarët shtetërorë? Cilat janë mangësitë kryesore të këtyre ligjeve?

Në dhjetor të vitit 2020 u përpilua një tekst i ri për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit, ku u pranuan pothuajse të gjitha propozimet e SHGM-së për zvogëlimin e masës së kompensimit për dëmin jomaterial në rast të fajit të gazetarit dhe plotësimin e pjesëve për përjashtimin nga përgjegjësia për shpifje dhe fyerje. Qëllimi i propozimeve të SHGM-së ishte zvogëlimi i gjobave të parapara, për të mos ndikuar negativisht në gazetarinë e lirë dhe kritike.

Sa padi janë ngritur kundër gazetareve nga funksionarët shtetërorë gjatë vitit të kaluar? A janë aktvendimet e gjykatës ndaj gazetareve të motivuar politikisht? Si janë dënimet e shqiptuara?

Numri i padive për shpifje dhe fyerje kundër gazetareve dhe mediave ka rënë në mënyrë dramatike që nga dekriminalizimi i shpifjes dhe fyerjes. Kështu, për dallim nga viti 2012, kur janë regjistruar 330 padi<sup>25</sup>, në vitin 2016 ka pasur 40, në vitin 2017- 39, kurse në vitin 2020-33 raste kur një palë është gazetar apo media. Sipas të dhënave të marra nga Gjykata Themelore Civile Shkup, numri i përgjithshëm i lëndëve aktive në të cilat si palë është gazetar/e apo media në vitin 2021 ka qenë 20. Gjatë vitit të kaluar, SHGM-ja nuk ka regjistruar ndonjë procedurë apo proces të përfunduar në të cilin është dënuar ndonjë gazetar apo është shqiptuar ndonjë dënim. Kjo tregon se shpifja dhe fyerja përdoren gjithnjë e më pak si instrument presioni ndaj gazetareve dhe mediave.

A e njohin gjykatat mekanizmin vetërregullues (nëse ka)? A e pranojnë ata vlefshmërinë e përgjigjes, korrigjimit apo faljes së publikuar?

Sipas avokatëve me të cilët bashkëpunon SHGM-ja, që i përfaqësojnë gazetarët në rastet gjyqësore për vepra që kanë të bëjnë me shpifje dhe fyerje, gjyqtarët në përgjithësi i marrin parasysh vendimet e Këshillit për Etikë në Media gjatë zhvillimit të procedurave gjyqësore. Përveç

kësaj, është praktikë e arritur që avokatët të përdorin vendimet e KEMM-së në procedurat gjyqësore si një argument shtesë në favor të gazetareve. Gjithashtu, në arsyetimet e aktgjykimeve, në të cilat të paktën njëra nga palët është gazetar, shpesh citohen raste nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, që shënon progres në krahasim me të kaluarën.

*“Qëllimi i vetë-rregullimit është, në fakt, shmangie e proceseve gjyqësore, gjegjësisht është një mundësi që personat e “dëmtuar”, në rastet e fyerjes dhe shpifjes, të kërkojnë satisfaksion moral pranë organeve vetërregulluese. Kjo do të thotë se nëse organi vetërregullues ka marrë një vendim kundër një gazetarit apo media të caktuar, dhe i dëmtuari, megjithatë, ka ngritur padi civile ... për shkak të fyerjes dhe shpifjes, Gjykata, vendimin e organit vetërregullues duhet ta konsiderojë si tentativë për të zbutur dëmin dhe jo ta trajtojë si rrethanë rënduese ndaj gazetarit apo medias së paditur. Ashtu sikurse kërkesa për falje dhe tërheqje në përputhje me Ligjin për fyerje dhe shpifje, edhe vendimi i Organit vetërregullues ka për qëllim zbutjen e dëmit, respektivisht të përmbushen të drejtat personale të të dëmtuarit” - Ivan Breshkovski, ekspert juridik dhe avokat.<sup>26</sup>*

Çfarë mendojnë gazetarët për Ligjin për shpifjen? A janë të dekurajuar të hulumtojnë dhe të shkruajnë në mënyrë kritike?

Disa gazetarë dhe punonjës mediatik<sup>27</sup> vlerësojnë se paditë për shpifje dhe fyerje janë përdorur më shumë si mjet për t'u bërë presion në të kaluarën. Megjithatë, në vitin 2021 ka pasur shembuj të presionit ndaj gazetareve, duke ngritur padi për shpifje apo fyerje nga politikanë apo njerëz të fuqishëm financiarisht.

Në rastin e presionit nga njerëz të fuqishëm financiarisht dëshmoi një gazetarë në fokus grupet:

*“Ne ishim në shënjestër të presionit kur hetuam për storjen e Laboratorit të Gazetarisë Investigative-IRL për furnizimin dhe shitjen e paligjshme të mjetëve të naf-tës si lëndë djegëse false në vend, që më pas ka qenë i shfrytëzuar si lëndë djegëse në spitale, institucione qeveritare dhe ministri, por edhe në objekte të mëdha industriale, si: ‘Feni’, ‘Brako’, etj. Në rrëfim theksohej zëvendëskryeministri i atëhershëm për Çështje Ekonomike, Koço Angjushev. Ai e ka kërcënuar redaksinë e IRL-së dhe redaktoren Sashka Cvetkovska me padi për të cilën procedura gjyqësore është ende në vazhdim.”*

25 SHGM, “Analizë: Aktgjykimet për shpifje dhe fyerje për lëndët gjyqësore me gazetarë”, Shkup, 2018. Qasur prej dt.: 21.12.2022. <https://znm.org.mk/analiza-presudi-za-kleveti-i-navredi-n/>

26 Ivan Breshkovski, ekspert juridik dhe avokat, intervistë e realizuar më dt. 20.12.2022.

27 Për nevojat e këtij hulumtimi u zhvillua një fokus-grup online me gazetarë më dt. 24.12.2021.

**A rregullohet pluralizmi politik në media në legjislaonin e medias jashtë periudhave zgjedhore? Cilat janë përgjegjësitë e servisit publik dhe radiodifuzerëve privatë në lidhje me pluralizmin politik jashtë periudhës zgjedhore?**

Ligji për shërbimet mediatike audio dhe audiovizuale nuk e përmend shprehimisht “pluralizmin politik” si detyrim i ofruesve të shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuale kur nuk është koha e fushatës zgjedhore. Megjithatë, parimet për kryerjen e veprimtarisë përbajnë nenin 61<sup>28</sup>, i cili u referohet të gjithë radiodifuzerëve dhe të cilin Rregullatori e përdor si bazë për monitorimin e raportimit të tyre në periudhën nga shpallja e zgjedhjeve deri në fillimin formal të fushatës zgjedhore, kur zbatohen dispozitat e parashikuara në Kodin Zgjedhor. Detyrimet për RTM-në në lidhje me këtë çështje, përveç parimeve për kryerjen e veprimtarisë, parashikohen edhe në nenet 110<sup>29</sup> dhe 111. Neni 111, i cili u referohet standardeve dhe parimeve në prodhimin ose transmetimin e programeve të servisit publik radiodifuziv u kushton disa pika për çështjen e pluralizmit dhe ekuilibrit në programet e RTM-së. Pika 2 u sugjeron gazetarëve dhe redaktorëve të RTM që “t’i përbahen parimit të ekuilibrit politik dhe pluralizmit të pikëpamjeve”.

**A është Organi rregullator i detyruar të monitorojë dhe mbrojë pluralizmin politik jashtë periudhës zgjedhore?**

Megjithëse nuk ka asnjë detyrim të qartë të Rregullatorit për të monitoruar pluralizmin politik jashtë fushatës zgjedhore, megjithatë në përgjegjësitë e përgjithshme të Rregullatorit është theksuar se “kujdeset për mbrojtjen dhe zhvillimin e pluralizmit të shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuale”, që përfshinë edhe këtë aspekt të pluralizmit politik. Në vitet e kaluara, Rregullatori ka bërë analiza të pluralizmit politik edhe jashtë periud-

hës zgjedhore, për të cilën ka miratuar një Doracak të posaçëm.<sup>30</sup>

**A kanë partitë politike dhe kandidatët qasje të drejtë dhe të barabartë në media jashtë periudhës zgjedhore?**

Gjatë vitit 2021, as Rregullatori dhe as ndonjë organizatë tjetër nuk ka bërë një analizë të pluralizmit politik në lajme, ndaj është e vështirë të përgjigjemi me saktësi nëse partitë politike kanë akses të drejtë në programet informative në mediat audiovizuale në periudhat jashtë zgjedhjeve. Megjithatë, vlerësimi i përgjithshëm i ekspertëve të mediave është se situata sot është përmirësuar ndjeshëm në krahasim me periudhën deri në vitin 2016, kur mediat audiovizuale më me ndikim raportonin vazhdimisht nën ndikimin e pushtetit partiak. Por, edhe pse mediat radiodifuzive, në përgjithësi, raportojnë për pikëpamje të ndryshme politike, brengosë fakti që në emisionet ditore-informative si përmbajtje dominojnë lajmet për “përleshjet” mes partive drejtuese.<sup>31</sup>

**Cilat janë detyrimet ligjore të mediave gjatë proceseve zgjedhore? Cili organ i monitoron mediat elektronike dhe të shtypura?**

Pluralizmi politik në raportimin mediatik gjatë fushatës zgjedhore rregullohet me Kodin Zgjedhor, i cili vlen edhe për servis publik edhe për mediat private, kurse Organi rregullator është i autorizuar të monitorojë programet në mediat radiodifuzive. Dispozitat e Kodit Zgjedhor për detyrimet e Servisit Publik Radiodifuziv në arritjen e ekuilibrit në emisionet ditore-informative janë jashtëzakonisht komplekse. Në fakt, RTM-ja përveç parimit të proporcionalitetit, sipas të cilit duhet të udhëhiqen të gjithë radiodifuzerët e tjerë, duhet t’i strukturuar lajmet sipas një formule komplekse: 30% kronika për ngjarjet ditore nga vendi dhe bota, 30% për aktivitete për partitë politike në pushtet, 30% për aktivitete të partive politike opozitare dhe 10% për aktivitete për partitë politike që nuk janë të përfaqësuara në Parlament. Ka edhe detyrime shtesë për trajtim të barabartë të të gjithë pjesëmarrësve në zgjedhje në qasjen në të gjitha format e përfaqësimit mediatik zgjedhor, si dhe ndalimin e mediave për t’u paraqitur si donatorë në fushatat zgjedhore të partive të caktuara politike.

Shumë dispozita të ligjit i referohen reklamimit të paguar politik - koha e lejuar, mënyra e shpërndarjes së kohës për reklamim politik etj. Ekzistojnë gjithashtu edhe dis-

28 Neni 61 i “Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale” e rregullon parimin për “prezantim objektiv dhe të paanshëm të ngjarjeve me trajtim të barabartë të pikëpamjeve dhe mendimeve të ndryshme dhe mundësimin e formimit të lirë të mendimit të publikut për ngjarje dhe çështje të caktuara”: <https://bit.ly/3NlJmqa>

29 Në nenin 110 të “Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale” përcaktohet obligimi i Servisit publik: “të sigurojë informim të vazhdueshëm, të saktë, të plotë, të paanshëm, të drejtë dhe në kohë duke krijuar dhe emetuar programe me cilësi të lartë për të gjitha ngjarjet e rëndësishme politike, ekonomike, sociale, shëndetësore, kulturore, arsimore, shkencore, religjioze, ekologjike, sportive dhe për ngjarje dhe zhvillime të tjera...”: <https://bit.ly/3NlJmqa>

30 ASHMAA, “Doracak për vlerësimin e pluralizmit politik”, Shkup: 2012. Qasur më dt.: 10.11.2021. <https://bit.ly/3NEJBxT>

31 Dejan Gerorgjievski nga Qendra për Zhvillimin e Mediave, i intervistuar më 30.1.2021



pozita që e rregullojnë sjelljen e mediave gjatë heshtjes zgjedhore, si dhe kufizime që kanë të bëjnë me mënyrën e publikimit të anketave parazgjedhore. Nga aspekti i mbrojtjes së pluralizmit politik, më kontestuese janë dispozitat e Kodit Zgjedhor që kanë të bëjnë me reklamimin politik. Qëndrimi i SHGM-së është se reklamimi i paguar politik në mediat audiovizuale duhet të hiqet, sepse ndikon negativisht në politikën redaktuese të mediave, por edhe e “zhvendos” balancën e qëndrimeve të kundërta në sferën publike. Aq më tepër që partitë politike kanë mundësi të japin “blejnë” hapësirën mediatike me mjete publike, përkatësisht nga Buxheti i RMV-së. Çështje shqetësuese nga aspekti i mbrojtjes së pluralizmit politik është se reklamimi i paguar politik në periudhën jashtë zgjedhjeve nuk ndalohet shprehimisht nga legjislacioni mediatik. Ky vakum në të kaluarën është keqpërdorur në formën e të ashtuquajturit reklamim i të arriturave të partisë në pushtet, por me mjete nga Buxheti. Për tejkalimin e këtij problemi nevojiten ndërhyrje në Ligjin për shërbimet mediatike audio dhe audiovizuale edhe në Kodin Zgjedhor, respektivisht të vendoset ndalesa për reklamimin e paguar politik në mediat private, në çdo periudhë.

#### A kanë partitë politike dhe kandidatët qasje të drejtë dhe të barabartë në media gjatë proceseve zgjedhore?

Nga monitorimi i realizuar i zgjedhjeve të parakohshme lokale, të mbajtura më 15 tetor të vitit 2021, Rregullatori i medias<sup>32</sup> ka konstatuar se të gjitha serviset komerciale në nivel kombëtar kanë bërë përpjekje për të ofruar mbulim mediatik të fushatës zgjedhore dhe, pothuajse të gjitha, krahas informimit në emisionet ditore-informative, për pjesëmarrësit në zgjedhje kanë rezervuar edhe më shumë programe informative speciale. Megjithatë, radiodifuzerët privatë nuk e kanë mbuluar fushatën në përputhje me parimet e barazisë për kandidatët për kryetarë komunash dhe proporcionalitetit për kandidatët për Këshilla Komunalë. Redaksitë e kanë përcjellë fushatën zgjedhore në mënyrë pragmatike, më së shumti sipas pritjeve nga përvoja e përgjithshme politike për proceset zgjedhore të deritanishme, duke u dhënë prioritet LSDM-së dhe VMRO-DPMNE-së dhe partnerëve të tyre të koalicionit e jo sipas parimeve fillëstare të kërkesave të theksuara ligjore. Mirëpo, për një konstatim të tillë ekzistojnë një sërë arsyesh objektive, në këtë rast duke filluar nga ajo themelore – numri i madh i kandidatëve të konfirmuar për qytetin e Shkupit,

për komunitatet e Shkupit veçmas, por edhe për të gjitha komunitatet tjera në vend.<sup>33</sup>

Rezultatet e monitorimit të OSBE/ODIHR<sup>34</sup> konfirmojnë se një numër i madh i mediave, të ndara sipas animit të tyre politik, operojnë në një treg të vogël reklamash. Televizionet dhe mediat online janë burimet kryesore të informacioneve politike. Servisi publik radiodifuziv, Radio Televizioni i Maqedonisë (RTM), financohet nga buxheti i shtetit, i cili, sipas mendimit të disa bashkëbiseduesve të ODIHR-it, reflektohet në pavarësinë e tij redaktuese.

#### A4 Liria e punës dhe e bashkimit të gazetarëve

#### A duhet që gazetarët të jenë të licencuar nga shteti që të mund të punojnë? A ka pasur tentativa për marrjen e lejeve nga shteti gjatë vitit të kaluar?

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, profesioni i gazetarisë nuk është subjekt i licencimit, por problemi është se Ligji për media ende përmban një përkufizim të termit gazetar.<sup>35</sup> SHGM-ja dhe organizata të tjera mediatike, që nga miratimi i këtij ligji në vitin 2013, kanë reaguar se kjo mund të kufizojë ushtrimin e lirë të profesionit të gazetarisë. Përcaktimi se kush është gazetar dhe kush mund të jetë gazetar nuk duhet t'i nënshtrohet ligjit, respektivisht kjo është një çështje që i nënshtrohet vetëm vetë-rregullimit nga profesioni i gazetarisë.

#### A janë refuzuar gazetarët të raportojnë nga vende apo ngjarje të caktuara për shkak se nuk kanë poseduar akreditim?

Në vitin 2021, SHGM-ja kishte vërejtur një rast të tillë gjatë zgjedhjeve lokale në vend, në tetor të vitit 2021, nga anëtarët e Këshillit zgjedhor në Tetovë, si dhe nga një përfaqësues i MPB-së të gazetarja Ferikan Iljazi Arifi, korrespondente nga “Euronews” Shqipëri. Lidhur me këtë rast, SHGM-ja ka parashtruar ankesë në Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve dhe në Departamentin e

32 ASHMAA, “Raport për raportimin mediatik në raundin e parë nga fushata për “Zgjedhjet Lokale 2021”; Shkup, 2021. Qasur prej dt. 24.12.2021. <https://bit.ly/3BXqck6>

33 ASHMAA, “Pasqyrë e procedurave të ngritura kundërvajtëse nga ASHMAA për zgjedhjet lokale 2021”; Shkup, 2021. Qasur prej dt. 26.1.2021. <https://qvmu.mk/lokalni-izbori-2021/>

34 OSBE/ODIHR, “Republika e Maqedonisë së Veriut: Zgjedhjet lokale 17 tetor viti 2021 (Raport periodik)”. Qasur më dt. 26.1.2022. <https://bit.ly/3uPkhqj>

35 Në nenin 2 të “Ligjit për media”, termi gazetar përkufizohet si “person që grumbullon, analizon, përpunon ose klasifikon informacioneve të publikuara në media dhe është i punësuar në media apo ka kontratë pune me to apo person që realizon aktivitetet gazetareske si profesion i pavarur (gazetar i lirë)”. <https://bit.ly/35unYlP>

Kontrollit të Brendshëm pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme. Në vitin 2021, ndryshe nga një vit më parë, gjatë konferencave për media në Qeveri, gazetarët nuk kishin pengesa për të bërë pyetje, sepse ato ishin të organizuara në përputhje me protokollet shëndetësore për mbrojtje nga pandemia COVID-19.

**A organizohen gazetarët në shoqata profesionale dhe si? A ka presion mbi shoqatën e tyre apo ndaj ndonjërit prej anëtarëve?**

Shumica e gazetarëve janë të organizuar në shoqata profesionale dhe, në këtë drejtim, nuk ka pasur pengesa apo presione gjatë vitit 2021. Shoqata më e madhe dhe më e vjetër është Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM), e themeluar në vitin 1946, anëtare e Federatës Ndërkombëtare të Gazetarëve (FNG) dhe Federatës Evropiane të Gazetarëve (FEG). SHGM-ja është organizatë udhëheqëse mediatike, e cila bashkon gazetarët në RMV-së për mbrojtjen e lirisë së fjalës, pavarësinë e mediave, duke u kujdesur për respektimin e standardeve më të larta etike për punën e mediave dhe gazetarëve. Shoqata përpqet të rrisë solidaritetin dhe unitetin gazetaresk, si dhe të ngritë nivelin profesional dhe normat etike të gazetarëve në RMV. Gjatë kësaj periudhe nuk është regjistruar asnjë presion ndaj SHGM-së apo anëtarëve të saj.

**A organizohen gazetarët në sindikata dhe si? A ka presione mbi drejtuesit e sindikatave dhe anëtarët e tjerë? A mund të anëtarësohen lirisht gazetarët në sindikata?**

Sa i përket mbrojtjes së të drejtave të punëtorëve, gazetarët dhe punonjësit mediatik janë të organizuar në kuadër të Sindikatës së Pavarur të Gazetarëve dhe Punonjësve Mediatik – SPGPM, e cila nuk është pjesë e asnjë organizate sindikale në nivel kombëtar. Ekziston edhe një sindikatë e veçantë e servisit publik radiodifuziv, e cila nuk është pjesë e SPGPM-së. Sipas përfaqësuesve të SPGPM-së, forma më e zakonshme e presionit ndaj gazetarëve anëtarë të sindikatave është kur pronarët ose drejtuesit e mediave shmangin që anëtarësimin sindikalist ta përllogaritin si pjesë e pagave të gazetarëve, duke i bërë ata të humbasin statusin e tyre si anëtarë sindikate.

*“Edhe këtë vit vërehet vazhdim i tendencës në disa media të mëdha për të penguar në mënyrë tërthortë anëtarësimin në sindikatë. Në agjencinë shtetërore MIA, me mbështetjen e menaxhmentit, është formuar*

*e ashtuquajtura ‘sindikata e verdhë’<sup>36</sup>. Sipas informacioneve që SPGPM-ja ka marrë nga anëtarët e saj pas një sërë aktivitetesh sindikale për të respektuar disa dispozita të kontratës kolektive, shumë anëtarë të SPGPM-së kanë anuluar anëtarësimin e tyre dhe i janë bashkuar të ashtuquajturës ‘sindikata e verdhë’<sup>37</sup>”*

**A ekziston Këshilli për Etikë në Media dhe si është organizuar ky organ? A ka presione mbi përfaqësuesit e Këshillit të Etikës?**

Këshilli për Etikë në Media në Maqedoni (KEMM) është organ vetërregullues, i cili ekziston që nga dhjetori i vitit 2013 dhe në të cilin, në baza vullnetare, janë anëtarësuar mediat dhe organizatat profesionale mediatike. Kusht për anëtarësim në KEMM është respektimi i parimeve dhe standardeve etike të Kodit të Gazetarëve dhe pranimit të Statutit të KEMM-it. Me këtë, anëtarët e KEMM-së janë të detyruar të përfshihen aktivisht në procesin e ndërmjetësimit dhe të publikojnë vendimet e Komisionit të Ankesave të këtij organi. Në fund të vitit 2019, me iniciativën e KEMM-it dhe SHGM-së, u krijua Regjistri i Mediave Profesionale Online dhe për t’u anëtarësuar mediat online këtu duhet të plotësojnë disa kritere,<sup>38</sup> të cilat përfshijnë këto detyrime: transparencën e strukturës së pronësisë, publikimi i impresumit, nënshkrimi i përmbajtjeve të publikuara nga gazetarët/autorët, regjistrimi i detyrueshëm i mediave online si subjekte juridike etj. Për më tepër, pranë SHGM-së ekziston edhe Këshilli i Nderit, si mekanizëm i brendshëm vetërregullues, i cili e monitoron respektimin e Kodit të Gazetarëve nga gazetarët-anëtarë të SHGM-së.

## **A5 Mbrojtja e burimeve të informacioneve**

**Si garantohet me ligj konfidencialiteti i burimeve gazetareske? Në çfarë kushtesh mund të kufizohet e drejta për mbrojtjen e burimeve?**

E drejta për mbrojtjen e burimit gazetaresk në RMV është e garantuar me Kushtetutë, por edhe në disa ligje: Ligji për përgjegjësinë civile për fyerje dhe shpifje, Kodi Penal, Ligji për media, Ligji për shërbime mediatike au-

<sup>36</sup> EN: A trade union that is dominated or influenced by an employer and thus not properly independent. <https://www.yourdictionary.com/yellow-union>

<sup>37</sup> Darko Duridanski, projekt menaxher në SPGPM, i intervistuar më dt. 28.1.2022.

<sup>38</sup> Rregullat për anëtarësimin e internet-portaleve në Regjistrë janë në dispozicion në <https://www.semm.mk/chlenstvo/pravila-za-chlenstvo>

dio dhe Audiovizuale dhe Ligji për mbrojtjen e sinjalizuesve. Aspektet që kanë të bëjnë me mënyrën e mbrojtjes së burimeve konfidenciale gazetareske janë shtjelluar në detaje në të gjitha këto ligje. Në vitin 2021, SHGM-ja nuk ka vërejtur shembull ku gazetarëve apo punonjësve mediatik u është kufizuar e drejta për mbrojtjen e burimit.

**A ka shembuj kur janë shqiptuar sanksione kundër gazetarëve që kanë refuzuar të zbulojnë identitetin e burimeve të tyre?**

Rasti i fundit i sanksionimit të gazetarëve që kanë refuzuar të zbulojnë identitetin e burimit të informacioneve është shënuar në vitin 2019<sup>39</sup>. Në vitin 2021, asnjë rast i vetëm nuk u regjistrua me kërkesë të gazetarëve për të zbuluar burimin dhe as për t'u sanksionuar për refuzimin e zbulimit të identitetit të tij.

**A munden gazetarët lirisht të kenë akses dhe të zhvillojnë kontakt me burimet e informacioneve?**

Në përgjithësi, gjatë përgatitjes së teksteve investigative, gazetarët ndjehen të lirë të kontaktojnë me burime konfidenciale të informacioneve. Me Ligjin i ri për mbrojtjen e sinjalizuesve<sup>40</sup> rregullohen çështjet e denoncimit të mbrojtur, të drejtat e sinjalizuesve, si dhe veprimet dhe detyrat e institucioneve në lidhje me denoncimin e mbrojtur dhe sigurimin e mbrojtjes së sinjalizuesve. Me ndryshimet në këtë ligj nga viti 2018 është kryer harmonizimi me standardet ndërkombëtare të parapara në këtë fushë dhe ofrojnë mbrojtje më të madhe për sinjalizuesit. Në këtë drejtim, burimet gazetareske inkurajohen dhe janë më të mbrojtura në formë institucionale. Gjatë vitit 2021 në SHGM-ja nuk ka pasur denoncime lidhur me rastet e mundshme të shkeljeve të këtij ligji.

## **A6 E drejta e qasjes në informata**

**Cilat janë rregullat ligjore për aksesin në dokumentet dhe informacionet zyrtare që janë të rëndësishme për gazetarët? A i shfrytëzojnë gazetarët këto rregulla? A i respektojnë institucionet rregullat, pa vonesë?**

Kuvendi i RMV-së në maj të vitit 2019 e miratoi Ligjin e ri për qasje të lirë në informata me karakter publik, sipas të cilit ish-Komisioni për mbrojtjen e të drejtës për qasje në informata me karakter publik u shndërrua në Agjenci, drejtori dhe zëvendës-drejtori i së cilës morën kompetenca më të mëdha gjatë zgjidhjes së ankesave dhe parashtrësve nga qytetarët. Ndryshimi më i rëndësishëm për gazetarët është ulja e afatit për t'u përgjigjur kërkesës, respektivisht për miratimin e vendimit, nga 30 në 20 ditë, me mundësi shtyrjeje edhe për 10 ditë. Lidhur me këtë çështje, gazetarët thonë se shpeshherë kanë probleme me respektimin e afateve nga ana e institucioneve, si dhe me faktin se përmbajtja e informacioneve të dorëzuara ndonjëherë nuk përputhet me kërkesën drejtuar institucioneve.

*"Na ndodh shpesh t'i dërgojmë pyetje të rregullta dhe në kohë një bartësi të informacioneve, të presim deri në ditën e fundit të afatit dhe, në fund, nga 4 pyetjet të marrim një përgjigje të përgjithshme vetëm për një pyetje", thekson gazetarja Bjanka Stankoviç, pjesëmarrëse në fokus grupin e gazetarëve të realizuar për nevojat e këtij hulumtimi. <sup>41</sup>*

Në raportin e saj vjetor<sup>42</sup>, Agjencia për Mbrojtjen e Qasjes së Lirë në Informata me Karakter Publik bën të ditur se nuk ka pranuar asnjë ankesë të parashtruar nga kërkuesit e informacioneve. Gazetarët që merren me gazetari hulumtuese theksojnë se, ndryshe nga më parë, komunikimi me stafin e Agjencisë është përmirësuar, ashtu që ata tregojnë mirëkuptim për problemet e tyre dhe u ofrojnë ndihmë në shfrytëzimin e Ligjit<sup>43</sup>. Sipas përvojave të gazetarëve që kanë parashtruar kërkesa për informacione në institucione, <sup>44</sup> afati i ankesës e ndërlikon më tej procesin, kurse praktika tregon se poseduesit e informatave me karakter publik zakonisht përgjigjen në ditën e fundit para skadimit të afatit.

39 Bëhet fjalë për akuzën parashtruar kundër gazetarit të portalit Infomaks për publikimin e procesverbalit nga një rast aktiv në Prokurori, në lidhje me çka SHGM-ja ka reaguar, duke theksuar se "Prokuroria nuk duhet t'i ndjekë ata që i kanë publikuar dokumentet, por personin që ka pasur qasje në dokumentet sekrete zyrtare dhe i ka nxjerrë për t'i dhënë një media... sepse ndjekjet e këtilla gjyqësore për më tepër mund të krijojnë efekt negativ mbi lirinë e shprehjes dhe të nxisin vetë-censurën tek gazetarët..."

40 „Ligji për mbrojtjen e sinjalizuesve”, 2016. Qasur prej dt. 9.12.2021. <https://bit.ly/35u7pU9>

41 Bjanka Stankoviç, „gazetare, deklaratë në fokus-grupin me gazetarë, realizuar më dt. 24.12.2021.

42 Raport vjetor i Agjencisë për mbrojtjen e qasjes së lirë në informata me karakter publik. Qasur më dt. 20.12.2022. <https://bit.ly/3qS1br0>

43 Fondacioni Metamorfozis, „Raport i sublimuar-final nga vëzhgimi i përbushjes së prioritetëve reformatore nga sfera e mediave (2019-2020)”, Ckonje: 2020. Qasur më dt. 17.12.2022. <https://bit.ly/3iUoYzH>

44 Fokus-grupe me gazetarë dhe punonjës mediatik, të organizuara më dt. 24.12.2021.

**A janë autoritetet transparente në përgjithësi? A ofrojnë marrëdhënie të hapura, jodiskriminuese dhe korrekte me mediat apo preferojnë të punojnë në fshehtësi? A kanë institucionet shtetërore një trajtim të privilegjuar ndaj atyre mediave që anojnë politikisht ndaj tyre?**

Vlerësim i përgjithshëm i shumë ekspertëve, gazetarëve dhe organizatave është se gjendja me transparencën e institucioneve është përmirësuar, por edhe se disa institucione shtetërore ende nuk janë mjaft të hapura dhe të përgjegjshme. Nga analiza e përgatitur nga Qendra për Komunikime Civile,<sup>45</sup> në kontekst të respektimit të afatit për përgjigje nga ana e institucioneve, rezultoi se nga gjithsej 460 kërkesa të adresuara nga Qendra për Komunikime Civile drejtuar institucioneve të ndryshme të pushtetit qendror dhe vendor, brenda afatit maksimal ligjor prej 20 ditëve është dhënë përgjigje në 51 për qind të kërkesave (234 kërkesa). 48% e kërkesave (221 kërkesa) janë përgjigjur pas afatit ligjor, ndërsa 1% e kërkesave (5 kërkesa) institucionet nuk janë përgjigjur edhe pas aktvendimit të Agjencisë.

**Sa janë të hapura Qeveria dhe Ministrinë për publikun?**

Gazetarët theksojnë se në kushtet e pandemisë, shumica e institucioneve ishin me transparencë të kufizuar, ose "aq sa u ka konvnuar atyre që drejtojnë institucionin".<sup>46</sup> Shumica e Ministrive vonoheshin me njoftimet dhe kumtesat e tyre, kurse Shërbimet e marrëdhënieve me publikun me njoftimet e tyre shpesh përpiqeshin të impononin qëndrimin apo këndvështrimin e tyre. Jo rrallëherë ka ndodhur që bartësit e funksioneve kanë qenë edhe më transparentë se shërbimet e tyre të marrëdhënieve me publikun, të cilat kanë qenë mjaft të mbyllura por, megjithatë, vërehet përmirësim në transparencë dhe hapje të institucioneve për dallim nga më parë. Megjithatë, kur bëhet fjalë për respektimin e afatave për dorëzimin e përgjigjeve në kërkesat e parashtruara në mënyrë të rregullt, në përputhje me Ligjin për qasje të lirë në informata me karakter publik, institucionet gjithmonë përdorin afatin maksimal për t'iu përgjigjur pyetjeve.<sup>47</sup> Gazetarët, përgjithësisht, vlerësojnë se transparenca në vitin 2021 është përmirësuar, ndryshe nga vitet e mëparshme. Vlerësohet se transparenca e Qeverisë së RMV-së është përmirësuar, krahasuar me institucionet e tjera shtetërore.

**A janë gjykatat transparente? A kanë mediat akses në proceset gjyqësore pa diskriminim dhe pa kufizime të panevojshme?**

Me kërkesë të Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, në mars të vitit 2021, Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM) ka dorëzuar propozimin për ndryshime në Rregulloren e Gjykatës,<sup>48</sup> e cila është e rëndësishme për funksionimin normal të gazetarëve dhe informimin në kohë dhe të saktë të publikut për punën e gjykatave. Për propozimin paraprakisht janë kryer konsultime me gjyqtarë dhe përfaqësues të kësaj Ministrie, si dhe me gazetarë që raportojnë për punën e gjykatave. Ndryshimet e propozuara kanë të bëjnë me transparencën e punës së gjykatave, aksesin e gazetarëve në procesverbalet gjyqësore dhe seancat gjyqësore, si dhe me përmirësimin e cilësisë së informacioneve të publikuara në ueb faqet e gjykatave. SHGM-ja ka theksuar edhe nevojën për krijimin e një Regjistri të zëdhënësve të institucioneve gjyqësore, që duhet të jetë publikisht i disponueshëm në ueb faqet e gjykatave dhe në ueb faqen [sud.mk](http://sud.mk).

Sipas gazetarëve, gjykatat në Shkup kanë dukshëm më shumë transparencë në krahasim me gjykatat tjera brenda territorit të vendit: "Gjykatat në pjesën perëndimore të vendit nuk janë mjaft transparente dhe është shumë e vështirë të merret ndonjë informacion prej tyre".<sup>49</sup>

**A është siguruar akses i publikut në seancat parlamentare? A ekzistojnë kufizime për gazetarët për të ndjekur punën e Parlamentit?**

Për Kuvendin e RMV-së te gazetarët ekziston një mendim i përgjithshëm se është më transparent se më parë, edhe pse shpeshherë ndodh të vonohet dorëzimi i përgjigjeve të kërkuara. Kryetari i Kuvendit, Talat Xhaferi mban takime të rregullta me gazetarë, me qëllim që gazetarët të jenë të azhurnuar me punën e Kuvendit dhe planet për punën e Legjislativit. Megjithatë, gazetarët që raportojnë nga Kuvendi nuk janë të informuar plotësisht dhe objektivist nga koordinatorët e grupeve parlamentare, të cilët nuk e kanë krijuar praktikën e informimit të rregullt të gazetarëve për realizimin e aktiviteteve të planifikuara, veçanërisht për mosmarrëveshjet në mes të pozitës dhe opozitës ose, nga ana tjetër, ndërmjet kryetarit të Kuvendit dhe një grupi të caktuar parlamentar. Gazetarët dhe publiku informohen atëherë kur deputetët vendosin që "zënka" të bëhet publike dhe kur vendosin të mbajnë konferenca për shtyp.<sup>50</sup>

45 Qendra për Komunikime Civile, "Analiza e zbatimit të Ligjit të ri për qasje të lirë në informata me karakter publik", Shkup: 2020. Qasur më dt. 18.01.2021. <https://bit.ly/3DitHNDI>

46 Fokus-grup me gazetarë dhe punonjës mediatic, organizuar më dt. 24.12.2021.

47 Ibid.

48 SHGM, "SHGM me propozime konstruktive për përmirësimin e Rregullores së Gjykatës", Shkup, 2021. Qasur prej dt. 28.12.2021. <https://bit.ly/36QyOAG>

49 Salije Sadiku, gazetarë e TV21, deklaratë në fokus-grupin me gazetarë, zhvilluar më dt. 24.12.2021.

50 SHGM, "Transparenca e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut gjatë pandemisë me Covid-19", Shtator, 2021. <https://bit.ly/3TV9zFM>

### **B1 Kufizimet ekonomike në punën e gazetarisë**

---

Sa gazetarë kanë nënshkruar kontrata pune? A kanë ata mbrojtje adekuate sociale? Sa të larta janë pagat e gazetarëve? A paguhen rregullisht?

---

Ende nuk ka të dhëna të sakta se sa gazetarë kanë kontrata pune në vend, por vlerësimi i përgjithshëm është se shumë gazetarë në mediat private kanë kryesisht kontrata me kohë të caktuar ose me kontratë mbi vepër. SPGPM-ja, në hulumtimin e fundit<sup>51</sup> mbi situatën ekonomike të gazetarëve dhe punonjësve mediatik zbuloi se 56,1 për qind e gazetarëve të anketuar janë punonjës me kohë të plotë, 19,1 për qind janë punonjës me kohë të caktuar, 10,4 për qind punojnë me kontratë mbi vepër, 12,2 për qind janë të angazhuar në formë honorari dhe 0.9 për qind thanë se punojnë vullnetarisht. Kur u pyetën se sa të kënaqur janë me të ardhurat dhe sigurinë e tyre ekonomike, më shumë se gjysma e gazetarëve (56.7%) thanë se ishin të pakënaqur. Por, gjatë kësaj, 31 për qind janë plotësisht të pakënaqur, kurse 25.7 për qind janë kryesisht të pakënaqur. Vetëm 2.7 për qind janë plotësisht të kënaqur dhe 22.4 për qind janë përgjithësisht të kënaqur. Kjo konfirmon se në vitin 2021, një numër i madh gazetarësh dhe punonjësish mediatik kishin status jashtëzakonisht të pasigurt të punësimit.

---

51 SPGPM, "Siguria dhe gjendja socio-ekonomike në media", Shkup: 2022. <https://bit.ly/3SuxWR7>

Situata edhe ashtu e vështirë socio-ekonomike e gazetareve u rëndua më shumë nga pandemia e shkaktuar nga Covid-19. Që nga fillimi i pandemisë, shumica e mediave i shkurtuan pagat e gazetarëve dhe punonjësve mediatik dhe shumë gazetarë janë ankuar se, ashtu si vitet e kaluara, nuk u janë paguar kontributet për sigurim pensional dhe social.<sup>52</sup> Shumica e gazetareve kanë të ardhura mujore shumë më të ulëta se paga mesatare në vend, e cila në vitin 2021 ishte 28.869 denarë. Megjithatë, paga e shumicës së gazetarëve të rinj, sipas sondazhit të SPGPM-së<sup>53</sup>, nuk e arrin as këtë shifër. Gjashtë për qind e gazetarëve të rinj të anketuar janë përgjigjur se marrin më pak se 25.000 denarë. Ndërsa 27 për qind prej tyre janë paguar nga 15.000 deri në 20.000 denarë. Pjesa e mbetur prej 12,9 për qind janë përgjigjur se paga e tyre është nga 25.000 deri në 30.000 denarë, përkatesisht 24.6 për qind se kanë pagë më të madhe se 30.000 denarë. Gjendja në servis publik është pak më e mirë, ku paga mesatare e gazetarëve në vitin 2020 ishte 38.120 denarë, edhe pse konsiderohet se pagat e gazetarëve, veçanërisht atyre që nuk janë fillestarë, janë më të ulëta se pagat e gazetareve në televizionet kombëtare private.<sup>54</sup>

### Cilat janë kushtet e punës së gazetarëve? Cilat janë problemet më të mëdha me të cilat përballen në vendin e punës?

Gazetarët vazhdojnë të punojnë pa pagesë jashtë orarit të punës, dhe pa kompensim edhe në ditë festash dhe fundjave. Karakteristikë për vitin e kaluar, por edhe për këtë vit është se disa gazetarë, për shkak të pandemisë, punonin nga shtëpia, ndërsa ata nga redaksitë më të mëdha, si televizionet kombëtare, punonin me turne. Për disa gazetarë, puna në kushte pandemie e vështirësoi edhe më shumë kryerjen e detyrave profesionale, veçanërisht për ata që ishin të ekspozuar ndaj situatave stresuese gjatë raportimit nga institucionet shëndetësore dhe spitalet. Në hulumtimin<sup>55</sup> e kryer nga Sindikata e Pavarur e Gazetarëve dhe Punonjësve Mediatik (SPGPM), e cila përfshinte 150 të anketuar

që punonin në media, zbuloi se efektet e pandemisë Covid-19, si frika, ankthi, depresioni dhe pasiguria i kanë ndjerë 61% e gazetarëve të anketuar. Gjysma e të anketuarve kanë punuar nga shtëpia, të tjerët kanë punuar në grupe, por disa prej tyre kanë punuar gjatë gjithë periudhës së pandemisë duke raportuar drejtpërdrejt nga ngjarjet dhe në vendet e tyre të punës.

## B2 Pavarësia redaktoriale në mediat private

A kanë miratuar mediat private dokumente organizative që lejojnë redaksitë të jenë të ndara dhe të pavarura nga strukturat e menaxhimit dhe marketingut? A kanë vendosur mediat private rregulla për pavarësinë redaktoriale nga pronarët e mediave dhe organet drejtuese? A respektohen ato rregulla?

Nga informacionet me të cilat disponon SHGM-ja dhe nga përgjigjet e marra përmes bisedave me gazetarë dhe punonjës mediatik, mund të konstatohet se akte të tilla janë të rralla. Nuk ka të dhëna apo rishikime të publikuara nga të cilat mund të përcaktohet se sa media private kanë akte apo rregulla të brendshme organizative, sipas të cilave redaksia formalisht ndahet nga menaxhmenti i medias. Në mediat më të mëdha, është e zakonshme që redaksitë të ndahen nga strukturat drejtuese, por shpesh ndodh që drejtorët të bëjnë presion mbi redaksitë për të punuar në një mënyrë që do të sigurojnë më shumë të ardhura nga sponsorizimet apo shpalljet. Kur bëhet fjalë për mediat më të vogla vendore, situata është edhe më e ndërlikuar, respektivisht presionet janë të shprehura ndryshe dhe vijnë si nga pronarët ashtu edhe nga autoritetet vendore. Madje gazetarët ankohen se "... ka një marrëveshje të heshtur për të shmangur disa tema".<sup>56</sup>

A kanë miratuar mediat private Kode të brendshme të etikës apo i përmbahen Kodit të përgjithshëm të etikës? I vetmi Kod që vlen për të gjithë gazetarët profesionistë është Kodi i Gazetarëve të Maqedonisë, i miratuar në vitin 2001,<sup>57</sup> i cili është bazë për veprim si nga Këshilli i Nderit të SHGM ashtu edhe nga Komisioni për Ankesa i Këshillit për Etikë në Media në Maqedoni. Nuk ka të dhëna që mediat private kanë kodet apo rregullat e tyre specifike të etikës. Këshilli për Etikë në Media në Maqedoni (KEMM) së fundi ka përpiluar udhëzime për raportim etik të mediave online,<sup>58</sup> përkatesisht ud-

52 Deklaratë e gazetarëve-pjesëmarrës në fokus-grupin e organizuar më dt. 24.12.2021.

53 SPGPM, "Anketë: Me pagë nën mesataren, gjysma e gazetarëve të rinj duan ta braktisin profesionin", Shkup: 2021. Qasur prej dt. 10.12.2022 <https://bit.ly/3K9EiQH>

54 Veçanërisht kategori e gazetarëve të rrezikuar janë korrespondentët e RTM, të cilët janë në numër të vogël dhe kryesisht kanë kontrata të përkohshme pune, që mund të zgjidhen lehtë. Në nëntor të vitit 2019 u publikua shpallje për angazhimin honorar për dhjetë korrespondentë, që është progres për RTM, edhe pse SHGM-ja bënë përpjekje që kjo të realizohet sipas një modeli tjetër, me të cilin në mënyrë sistematike dhe të përhershme do të zgjidhej çështja me këtë kategori të gazetarëve. Shih më shumë: SHGM, "Dokument për politikë publike: Statusi dhe nevoja e korrespondentëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut", Shkup: 2019. Qasur më dt. 16.12.2021. <https://bit.ly/3eiOYNq>

55 SPGPM, "Frika dhe ankthi është çmimi që e paguan gazetarët gjatë raportimit mbi pandeminë Covid-19", Shkup, 2021. Qasur prej dt. 12.1.2022. <https://bit.ly/3qWNqVp>

56 Deklaratë e një gazetari-pjesëmarrës në fokus-grupin e organizuar më dt. 24.12.2021.

57 SHGM, "Kodi i Gazetarëve të Maqedonisë". <https://znm.org.mk/kodeks-na-novinarite-na-makedonija/>

58 KEMM, "Udhëzime për raportim etik të mediave online – Aplikimi i Kodit të Gazetarëve në sferën online", Shkup, 2020. Qasur më dt. 26.12.2021. <https://bit.ly/2RRdYZP>

hëzime për aplikimin e Kodit të Gazetarëve në sferën online.

**Cilat janë format më të zakonshme të presionit nga pronarët dhe drejtuesit e mediave mbi redaksitë apo gazetarët? Cili ishte shembulli më ilustrues i presionit të pronarëve apo drejtuesve të mediave ndaj një redaksie apo gazetari gjatë vitit të kaluar?**

SHGM-ja nuk ka informacione konkrete për presionin e ushtruar nga menaxhmenti ndaj gazetarëve gjatë vitit 2021, por fakt është se gazetarët rrallëherë raportojnë raste të tilla. Presionet zakonisht nuk shprehen si kërcënime të drejtpërdrejta, por janë delikate dhe pak të dukshme. Gazetarët nuk i padisin redaktorët dhe pronarët e mediave kur u shkelen të drejtat e tyre. Për shembull, vitin e kaluar nuk ka pasur asnjë rast gjyqësor të hapur ku një gazetar ka paditur një menaxher për mobing dhe, gjithashtu, nuk ka pasur një aktgjykim të plotfuqishëm për një vepër të tillë. Nga ana tjetër, lidhja mes pronarëve të mediave të caktuara dhe qendrave të pushtetit shpesh është në dëm të gazetarëve që punojnë në këto media.

*Në vitin 2021, SHGM-ja ka evidentuar raste të largimit nga puna të punonjësve mediatik nga televizioni kombëtar TV Alfa para fundit të vitit 2021, kur menaxhmenti ka shkarkuar gjashtë punonjës, të cilët ishin edhe anëtarë të Sindikatës. Për këtë rast, më 24 dhjetor të vitit 2021, Sindikata e Pavarur e Gazetarëve dhe Punonjësve Mediatik (SPGPM) dhe Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM) kishin një konferencë të përbashkët për media në të cilën reagues ash-për për ngjarjet në TV Alfa. Në konferencën për media u theksua se këto shkarkime pasuan protestën në televizion dhe përfaqësojnë hakmarrje për veprimtarinë sindikaliste, gjegjësisht kërkesat e punonjësve mediatik për përbushjen e të drejtave të tyre të punës.*

### **B3 Pavarësia redaktuese në radiodifuzerin publik**

**A ka miratuar servisi publik radiodifuziv Kod sjelljeje për gazetarët dhe pavarësinë redaktuese? A i përmbahen gazetarët këtij Kodit?**

Servisi publik e miratoi Kodin e Etikës për Gazetarët, stafin krijues dhe të gjithë punonjësit në RTM në vitin

2017.<sup>59</sup> Ky Kod, i cili ka gati gjashtë vjet që është në fuqi, është kritikuar që në fillim nga komuniteti gazetaresk për përmbajtjen e dokumentit, por edhe për mungesën e transparencës në hartimin e tij. E meta më e madhe e Kodit është ndërhyrja e etikës gazetareske në disiplinën e punës dhe me të drejtat dhe detyrimet e gazetarëve që rrjedhin nga marrëdhëniet e punës. Komisioni i Etikës pranë RTM-së, i cili është përgjegjës për monitorimin e respektimit të Kodit, nuk ka pranuar asnjë ankesë në të kaluarën. Prandaj, SHGM-ja në vitin 2021 kërkoi ndryshimin e Kodit të Etikës së RTM-së dhe përcaktimin e procedurave për parashtrimin e ankesave dhe mënyrën e punës së Komisionit të Etikës, të cilat do të publikoheshin në ueb faqen e RTM-së.

**A kanë vendosur organet e servisit publik radiodifuziv rregulla të brendshme organizative për të mbrojtur pavarësinë e redaksive nga ndikimi i organeve drejtuese? A respektohen ato rregulla?**

Servisi Publik ka miratuar aktet e tij të brendshme organizative, sipas të cilave redaksitë ndahen zyrtarisht nga strukturat drejtuese. Megjithatë, në ueb faqen e Radiotelevizionit të Maqedonisë është e vështirë të gjejmë informacione për rregullat në strukturën e brendshme organizative dhe funksionimin e organeve dhe trupave të saj. Ashtu si në vitet e mëparshme, edhe në vitin 2021 mund të thuhet se nuk janë bërë ndryshimet thelbësore të pritshme në strukturën e brendshme të servisit publik, të cilat supozohej të ishin pjesë e procesit të reformës së medias.

**Cilat janë format më të shpeshta të presionit që i aplikon pushteti ndaj redaksive apo gazetarëve individualë në servisin publik?**

Nuk mund të thuhet se RTM-ja apo gazetarët në redaksitë e saj kanë qenë nën ndikimin e drejtpërdrejtë të pushtetit në vitet e fundit. Mirëpo, në kërkesat për reforma në media është theksuar vazhdimisht se nevojitet departizimi i servisit publik, përkatësisht zgjedhja e Këshillit të ri Programor të pavarur dhe organe të reja udhëheqëse. Mjetet për financimin e veprimtarisë radiodifuzive, për punën dhe zhvillimin e Radiotelevizionit të Maqedonisë, ndërmarrjes publike Radiodifuzioni i Maqedonisë dhe Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë në shumë prej 0,8% deri në 1% të hyrave të realizuara të përgjithshme në vitin që i paraprinë vitit fiskal për të cilin është përcaktuar shuma. Mjetet ndahen në këtë mënyrë: 74,5 për

<sup>59</sup> RTM, "Kodi Etik i RTM për gazetarët, kuadrot kreativë dhe për të gjithë të punësuarit në RTM", Shkup, 2017. Oasur prej dt. 3.2.2022. <https://bit.ly/3uL62ZC>

qind për RTM-në, për mbulimin e shpenzimeve për krijimin dhe transmetimin e programeve dhe për zhvillimin tekniko-teknologjik, 19,5 për qind për NP Radiodifuzioni i Maqedonisë për mirëmbajtjen, shfrytëzimin dhe zhvillimin e rrjetit të transmetimit publik dhe 6 për qind për Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Burim shtesë i mjeteve për financimin e RTM-së janë donacionet, shitja e programeve dhe shërbimeve, si dhe mjete të tjera. Në seancën e mbajtur në dhjetor të vitit 2021, Qeveria ka marrë vendim<sup>60</sup> për rritjen e buxhetit të Ministrisë për Shoqëri Informatike dhe Administratë për vitin 2022, në vlerë prej 250 milionë denarë për realizimin e aktiviteteve programore të Radio Televizionit të Maqedonisë dhe me këtë rritje prej 4 milionë eurosh, buxheti i RTVM-së në vitin 2022 do të jetë 15 milionë euro. RTM-ja ka miratuar një strategji zhvillimore pesëvjeçare, por procesi i reformës është penguar nga vonesat në emërimin e anëtarëve të rinj në Këshillin Programor të RTM-së dhe Këshillin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Anëtarëve aktualë të të dy organeve tashmë u ka skaduar mandati. Në Raportin e Komisionit Evropian theksohet se pavarësia financiare dhe zgjedhja e organeve drejtuese, sipas sistemit të meritës, janë dy parakushtet bazë për pavarësinë e servisit publik.

#### **B4 Pavarësia redaktoriale në sektorin jofitimprurës**

**A kanë miratuar mediat nga sektori jofitimprurës një kod sjelljeje për gazetarët dhe për pavarësinë redaktoriale? A i përmbahen gazetarët këtij Kod?**

Disa media online që financohen kryesisht ose tërësisht nga donatorët dhe mbulojnë gazetarinë investigative, si dhe një radio stacion që transmeton përmbajtje rinore në internet, bien në kategorinë e mediave online jofitimprurëse. Po ashtu, media jofitimprurëse janë edhe tri radiot studentore që funksionojnë në kuadër të tri universiteteve shtetërore (Universiteti "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup, Universiteti "Shën Kliment Ohridski" në Manastir dhe Universiteti "Goce Dellçev" në Shtip) dhe një radio fetare në Strumicë. Redaksitë e këtyre mediave janë të vogla përfshijnë disa gazetarë, të cilët punojnë në baza ditore dhe financimi i tyre është jostabil dhe i paqëndrueshëm. Disa nga mediat informative jofitimprurëse online janë të regjistruara si shoqata qyte-

tare dhe deri më tani nuk është bërë një analizë e plotë për punën e tyre dhe statusin dhe pavarësinë e gazetarëve në to.

Nuk ekziston një kod specifik të sjelljes për gazetarët në sektorin jofitimprurës, por në dhjetor të vitit 2020, Këshilli për Etikë në Media (KEMM) miratoi udhëzime për raportimin etik të mediave online<sup>61</sup>, të cilat, në fakt, shtellojnë zbatimin e parimeve etike të Kodit të gazetarëve në sferën online. Gjithashtu, KEMM dhe SHGM kanë krijuar një Regjistër të Mediave Profesionale Online,<sup>62</sup> i cili tashmë përfshin 152 media online, duke përfshirë edhe ato jofitimprurëse. Shumica e këtyre mediave e kanë pranuar ose kanë vepruar në përputhje me Kodin e Etikës dhe Udhëzimet e Raportimit të Etikës në Media Online, për zbatimin e të cilave kujdeset KEMM-i.

**Cilat janë format më të zakonshme të presionit ndaj mediave në sektorin jofitimprurës? Cili është shembulli më ilustrues i presionit mbi mediat në sektorin jofitimprurës?**

Presioni ndaj mediave jofitimprurëse, disa prej të cilave merren me gazetari investigative, ka rënë në krahë me periudhën deri në vitin 2016, kur gazetarët dhe redaktorët e këtyre mediave shpesh diskreditoheshin dhe sulmoheshin ashpër në publik për shkak të shkrimeve kritike për pushtetin e atëhershëm dhe pushtetarët. Shembull i presionit në një media jofitimprurëse në vitin e kaluar është rasti i Laboratorit të Gazetarisë Hulumtuese<sup>63</sup> i cili u kërcënua me padi nga ish-zëvendëskryeministri për Çështje Ekonomike Koço Angjushev pas një lajmi të transmetuar ku përmendet përfshirja e tij në importin dhe shfrytëzimin e vajrave toksikë. Procedurat gjyqësore për këtë rast janë ende në vazhdim në Gjykatën Penale në Maqedoninë e Veriut.<sup>64</sup> Paditë e tilla njihen si padi për parandalimin e pjesëmarrjes strategjike publike (SLAPP) dhe kanë për qëllim të frikësojnë dhe financiarisht t'i dobësojnë gazetarët e paditur ose mediat. Kur inicohen nga politikanë dhe bartës të funksioneve publike, këto procese gjyqësore mund të shkaktojnë frikë dhe auto-censurë tek gazetarët, duke shkelur kështu të drejtën e qytetarëve për t'u informuar.

*Këshilli i Nderit pranë Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM) ka vepruar pas ankesës së ish-zëvendëskryeministrit për Çështje Ekonomike*

61 KEMM, "Udhëzime për raportim etik në mediat online". Qasur më dt. 9.12.2022 <https://bit.ly/3tg60bx>

62 Regjistri i mediave profesionale online në Republikën e Maqedonisë së Veriut <https://promedia.mk/>

63 IRL, "Konspiracion kundër ajrit ose si Maqedonia mbeti depont e fundit evropiane". Qasur më dt. 10.12.2021. <https://bit.ly/3NNT1aE>

64 Fokus, "Angjushevi do ta padisë IRL-në për dokumentarin për mazutin kontestues". Qasur më dt. 20.12.2021. <https://bit.ly/3j4vpAc>

60 Qeveria e RMV, "Nga seanca e 124 e Qeverisë: Qeveria i ka 'ngrirë' çmimet e artikujve themelorë; Janë pranuar një pjesë e amendamenteve; Buxheti i vitit 2022 shkon për miratim në Kuvend; U miratua strategjia fiskale për 2022-2024", Shkup, 2021. <https://vlada.mk/node/27162>



*Koço Angjushev lidhur me video-storjen "Konspiracion kundër ajrit" të realizuar nga IRL për emisionin "Redakcija". Këshilli i Nderit e shqyrtoi ankesën për Sashka Cvetkovskën, gazetare e IRL-së, si autore të emisionit "Konspiracion kundër ajrit" të publikuar në TVM. Në ankesë thuhet se Cvetkovska ka shkelur dy nene të Kodit dhe se me joprofesionalizmin dhe joetikën e saj ka synuar të dëmtojë reputacionin e Koço Angjushevit. Nisur nga serioziteti i pretendimit, Këshilli i Nderit i kërkoi përgjigje IRL-së dhe pas këqyrjes së dokumentacionit të dorëzuar dhe listës së komunikimeve, konstatoi se ankesa ishte e pabazuar, respektivisht nuk kishte shkelje të Kodit të Gazetarëve. Nuk është konstatuar asnjë shkelje e Kodit edhe nga Komisioni i Ankesave pranë Këshillit për Etikë në Media, i cili, gjithashtu, e shqyrtoi këtë rast.*

## **B5 Liria e gazetarëve në procesin e prodhimit të lajmeve**

Sa liri kanë gazetarët në përzgjedhjen e storjeve gazetareske me të cilat do të punojnë dhe në vendosjen se cilat aspekte të një storjeje duhet të theksohen? Sa shpesh marrin pjesë gazetarët në redaktimin dhe koordinimin e politikave redaktuese?

Sipas deklaratave të bashkëbiseduesve në intervista dhe në fokus grupe, shumica e gazetarëve gjatë vitit 2021 kanë pasur lirinë të zgjedhin temat për të cilat do të raportojnë.<sup>65</sup> Megjithatë, zgjedhja e temave për raportim në mediat rajonale dhe në ato lokale është një problem më i madh për gazetarët për shkak të mjedisit të vogël në të cilin funksionojnë këto media, për shkak të lidhjeve të krijuara klienteliste të pronarëve me kryetarët e komunave dhe njerëzve të fuqishëm lokal, si dhe për shkak të gjendjes së keqe financiare që janë këto media. Flitet hapur edhe për ndikimin e disa redaktorëve tek gazetarët, duke theksuar se ndikimi në punën e përditshme nuk është aq i dukshëm, respektivisht ka më shumë auto-censurë sesa presione të drejtpërdrejta.

<sup>65</sup> Deklaratë e njërit prej pjesëmarrësve në fokus-grupin e organizuar më dt. 24.12.2021: "Kemi liri të plotë, asnjëllaj censure. Kjo më ndihmon shumë të ngritëm si gazetarë, por edhe të mësoj shumë gjëra se si në fakt sistemi është jotransparent dhe shumë vështirë arrihet në përgjigjet e vërteta për të cilat luftojmë t'ia përcjellim opinionin".

Cili është perceptimi i vetë gazetarëve për sa i përket ndikimit të tyre nga burime të ndryshme ndikimi? A i nënshtrohen auto-censurës gazetarët për shkak të frikës për humbjen e punës apo për shkak të presioneve të tjera?

Gazetarët thonë se problemi më i madh është fakti se pronarët e mediave këtë nuk e kanë biznes themelor. Më shpesh, në prapavijë të mediave janë kompani të tjera, të cilat, nga ana tjetër, janë të lidhura me tenderë me Ministri dhe institucione dhe, nga ky aspekt, ekzistojnë tema tabu për media të caktuara. Kjo situatë është veçanërisht e theksuar në mediat lokale. Në këtë kontekst, gjatë vitit të kaluar, duke qenë se kriza shëndetësore e shkaktuar nga pandemia ishte ende aktuale, gazetarët dhe punonjësit e mediave u ndjenë edhe më të pasigurt në punën e tyre, gjë që çoi në demotivim dhe auto-censurë. Perceptimi dominues tek gazetarët është se redaksitë e dinë paraprakisht se cilat tema janë të pranueshme, gjegjësisht cilat tema do t'i vlerësojë redaktori si të shkëlqyeshme dhe cilat do t'i refuzojë.

## **B6 Pozita ekonomike e gazetarëve**

A punojnë gazetarët në kushte më të këqija pune në krahasim me kolegët e tyre gazetarë? A nënshkruajnë kontrata pune aq shpesh sa gazetarët?

Vlerësimi i përgjithshëm është se pozicioni i gazetarëve në redaksi nuk ndryshon shumë nga pozicioni i gazetarëve. Nuk ka të dhëna se sa gazetarë dhe gazetarë kanë nënshkruar kontrata pune, por konsiderohet se punëdhënësit në përgjithësi, kur bëhet fjalë për gazetarë të punësuar për një kohë të pacaktuar, i respektojnë të drejtat elementare të përcaktuara me ligj, siç është pagesa e pagave, pushimi i lehonisë dhe pushimi me pagesë. Megjithatë, është fakt se diskriminimi gjinor dhe pozita e pafavorshme e grave, në krahasim me atë të burrave, në vendin e punës shpeshherë nuk njihet nga vetë gazetarët. Në vitin e kaluar, SHGM-ja dhe SPGPM-ja nuk kanë regjistruar ndonjë rast të denoncimit nga ana e gazetarëve për diskriminim në vendin e punës.

A janë gratë në pozicione drejtuese në redaksi njësoj si burrat?

Sipas deklaratave të vetë gazetarëve dhe gazetarëve, në përgjithësi, mundësitë e grave për t'u zhvilluar si gazetarë profesioniste dhe për të avancuar në karrierë nuk janë shumë më të vogla në krahasim me

mundësitë e kolegëve të tyre gazetarë.<sup>66</sup> Por, për ekzistencën e të ashtuquajturit “tavani i qelqtë” ose “pengesa e padukshme në hierarki që pengon gratë ose minoritetet të fitojnë poste në nivele më të larta”, flasin të dhënat mbi strukturën e stafit të sektorit audiovizuel të publikuar nga Rregullatori i mediave: në redaksitë televizive gazetarët janë në numër më të madh se gazetarët. Numri i përgjithshëm i të punësuarve në industri<sup>67</sup> në fund të vitit 2020 ishte 2587 persona, nga të cilët 61% ishin burra dhe 39% gra. Shumica e burrave (577 persona) ishin realizatorë, kurse e gjysma e grave (509 gra) punonin si gazetare. Në televizionet e nivelit shtetëror, të cilët transmetojnë program përmes multipleksit tokësor kanë qenë të punësuar 60 për qind të tyre me marrëdhënie të rregullt pune. Gratë kanë qenë në numër më të madh ndër gazetarët, tek sektori i marketingut si dhe pjesë tjetër e stafit, ndërsa, nga ana tjetër, tek të gjitha vendet e tjera të punës kanë qenë të angazhuar më shumë burra sesa gra. Dallimi më i madh ishte në kuadrin realizues, ku kanë qenë të angazhuar 319 meshkuj më shumë se femra.

Nga ana tjetër, ka media si MIA (Agjencia Informative Mediatike) dhe IRL (Laboratori i Gazetarisë Hulumtuese), ku “gratë janë më të shumta se kolegët e tyre gazetarë dhe kanë një rol të rëndësishëm udhëheqës në redaksi”.<sup>68</sup>

## Sa janë pagat e tyre në krahasim me rrogat e kolegëve gazetarë? A përballen gratë gazetare me presione specifike mbi bazën gjinore brenda dhe jashtë redaksive?

Pagat e gazetarëve dallojnë në varësi të pozicionit të gazetarit dhe nuk ka dallim nëse bëhet fjalë për femra apo meshkuj. Sipas analizës së SPGPM-së,<sup>69</sup> paga mesatare neto e gazetarëve në dy vitet e fundit ishte 350 euro. Në vitin 2020, shumica e gazetarëve dhe punonjësve mediatik kanë marrë paga prej 15.000 deri në 20.000 denarë. Kjo do të thotë se 70 për qind e gazetarëve në Maqedoni marrin pagë mujore nën mesataren. Sipas të dhënave të Entit Shtetëror për Statistikë,<sup>70</sup> paga mesatare mujore e paguar neto për punonjës në nëntor të vitit 2021 ka arritur 29.130 denarë.

Në rastet e raportimit për tema të ndjeshme, gazetarët pësojnë ofendime dhe poshtërime, të cilat ua prishin reputacionin personal dhe profesional, me kualifikime që vlejnë vetëm për gratë, në kuptimin përshkrues, të bazuara në paragjykime dhe stereotipa gjinorë. Bëhet fjalë për një fenomen që indirekt reflektohet në të ardhmen e tyre profesionale dhe në jetën e tyre private.<sup>71</sup> Më shpesh, ky lloj problemi lidhet me rolet gjinore patriarkale të vendosura në shoqëri, por edhe me mungesën e rregullave të qarta, procedurave, akteve të brendshme në vetë organizatat mediatike, të cilat do të hapin rrugën dhe do të vendosin udhëzime për sigurimin e barazisë gjinore.

66 Sonja Trajkovska Dimitrova, “Pozita strukturore e gazetarëve femra në media në Maqedoi”, Shkup, IMM, 2018, fq. 6. Qasur prej dt. 15.12.2021 <https://bit.ly/3r29s9n>

67 ASHMAA, “Struktura e të punësuarve në industrinë mediatike audio dhe audiovizuale në vitin 2020”, Shkup, 2021. Qasur prej dt. 31.1.2022 <https://bit.ly/3JddiTC>

68 Deklaratë e pjesëmarrësve në fokus-grup, zhvilluar më dt. 24.12.2021.

69 SPGPM, «Gazetarët dhe punonjësit mediatik me paga shumë më pak se mesatarja», Shkup: 2020. Qasur prej dt. 21.1.2021. <https://bit.ly/3lttkd>

70 Enti Shtetëror i Statistikës, “Kumtesë: Paga mesatare mujore neto e paguar, janar 2022, Qasur prej dt. 21.1.2022 <https://www.stat.qov.mk/PrikaziSoopstenie.aspx?rbtxt=40>

71 Nita Starova, “Dokument për politika: Zbrazëtirat kryesore sistematike dhe zgjidhjet e mundshme për tejkalimin e pengesës në pagat dhe problemet potenciale me rregullimin hierarkik në media të bazuara në diskriminimin gjinor”, Shkup, 2022. <https://bit.ly/3qZCDiV>



## C1 Statistikë për sigurinë dhe për mosndëshkimin

Sipas statistikës së SHGM-së, që nga fillimi i vitit 2021 janë regjistruar gjithsej 5 sulme dhe kërcënime të ashpra ndaj gazetarëve, prej të cilave 3 janë kundër grave gazetare. Sa për krahasim, vitin e kaluar ka pasur 14 incidente të tilla, që do të thotë se këtë vit sulmet dhe kërcënimet janë zvogëluar. Por, gazetarët dhe punonjësit mediatik ndihen ende të pasigurt për inercinë e Prokurorisë dhe Gjyqësorit në trajtimin e rasteve të kaluara të sulmeve. Megjithëse gazetarët janë përgjithësisht më të sigurt se më parë, ka ende nevojë për zgjidhje sistemike që do të garantojnë mbrojtjen afatgjatë të të drejtave dhe integritetit të të gjithë punonjësve mediatik në vend. Shqetësues është edhe fakti se në rrjetet sociale gjithnjë e më shumë ka kërcënime për jetën e gazetarëve. Në këtë drejtim, Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) pritet të bëjë më shumë përpjekje për sanksionimin e autorëve, ndërsa për raste më të rënda të kërkojë nga Prokuroria Themelore Publike (PTHP) që të iniciojë procedura penale.

Ndryshe, në periudhën nga viti 2018 deri në vitin 2021, në Regjistrin e SHGM-së janë regjistruar gjithsej 26 sulme ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik, nga të cilat në vitin 2018 janë regjistruar tri sulme, në vitin 2019 janë regjistruar katër, në vitin 2020 - 14 dhe në vitin 2021 - 5 sulme ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik. Karakteristike është se numri i sulmeve verbale dhe online është rritur: nga gjithsej 5 kërcënime të regjistruara në vitin 2021, madje katër kërcënime kanë qenë online. Për 15 vitet e fundit, autoritetet nuk kanë hetuar vrasjen e një gazetari apo punonjësi mediatik në vend.

Në kategorinë e parë e sulmeve – Kërcënime dhe maltretime që nuk kanë të bëjnë me sigurinë fizike të gazetarëve, bëjnë pjesë tre rastet e sulmit verbal ndaj gazetarëve Xhumadije Ibraimi nga TV Klan Maqedoni, Ferikan Iljazi Arifi nga Euronews Albania dhe Salije Sadiku nga TV 21. Xhumadije Ibraimi u ballafaqua me sulme verbale nga kandidati i Aleancës për Shqiptarët për kryetar komune në Tetovë, Vullnet Murseli. Menjëherë pas përfundimit të debatit televiziv, Murseli në rolin e të ftuarit, në prani të disa gazetarëve dhe personave të tjerë, ka shpifur ndaj gazetares Dzumadije Ibraimi<sup>72</sup> se kinse e ka shantazhuar me 10 mijë euro për të fshirë një postim të caktuar në Facebook. Sipas gazetares, motivi i përhapjes së këtyre gënjeshtreve kanë qenë tekstet dhe postimet e saj të mëparshme për një laborator privat, ku i ka kërkuar gazetares që të fshijë të gjitha përmbajtjet e saj të publikuara për laboratorin e pretenduar. Ngjarja ka ndodhur në fillim të fushatës elektorale për zgjedhjet lokale 2021, por për faktin se Vullnet Murseli ka qenë pjesëmarrës i drejtpërdrejtë në këto zgjedhje, redaksia e TV Klan Maqedoni dhe gazetarja Xhumadije Ibraimi nuk kanë reaguar në këtë moment për të mos u keqinterpretuar nga partitë politike.

Rasti i dytë ka të bëjë me gazetaren Ferikan Iljazi Arifi,<sup>73</sup> e cila ishte sulmuar verbalisht nga një anëtar i Këshillit zgjedhor dhe një përfaqësues i MPB-së gjatë raportimit mbi zgjedhjet lokale të vitit të kaluar. Ndonëse gazetarja është prezantuar në mënyrë të rregullt dhe ka pasur bexhin në vend të dukshëm që është gazetarë, kryetarja e Këshillit Zgjedhor Isnije Mirta nuk e ka lejuar të filmojë në vendvotimin në shkollën e mesme “Kiril Pejçinoviç” në Tetovë dhe gjatë kësaj me anëtarët tjerë të Këshillit para votuesve e ka poshtëruar duke i thënë “...ti nuk e njej ligjin dhe duhet të të vijë turp që po pengon procesin zgjedhor”. Një tjetër incident ka ndodhur gjatë ditës, sërish në Tetovë, në oborrin e një shkolle të mesme, ku një zyrtar i MPB-së, për të cilin tashmë është dorëzuar kallëzim në SPB Tetovë dhe në Departamentin e standardeve profesionale, në vend që të lejohet gazetarja të punojë lirshëm, ai e ka penguar në punën e saj. Ky rast është denoncuar në MPB, por ende nuk është zgjidhur.

Rasti i tretë në këtë kategori është sulmi verbal ndaj Salije Sadikut<sup>74</sup> nga kandidati i pavarur për kryetar të Komunës së Kërçovës, Fatmir Limani. Ndërsa gazetarja Salije Sadiku ishte duke raportuar për zgjedhjet lokale, ajo u përball me një situatë të sikletshme e ndjekur me

fjalim agresiv dhe akuza nga ana e kandidatit të pavarur nga Kërçova, Fatmir Limani ndaj saj personalisht dhe ndaj TV 21. Sadiku ka qenë e pranishme në ngjarje për të informuar qytetarët për ciklin zgjedhor dhe, në vend që të merrte përgjigje nga kandidati, ajo është ofenduar ashpër dhe më pas është brohoritur nga turma.

Në kategorinë e kërcënimeve për jetën dhe sigurinë fizike të gazetarëve, është regjistruar sulm<sup>75</sup> ndaj mediave dhe kërcënim ndaj një grupi gazetarësh të mediave Pa censurë, TV 21, Gazeta Express, Tetova Sot, Koha TV, Koha News, Kumanova Sot, TV Shenja dhe Lajmi Press përmes profilit të Facebook të Arben Esatit, ku janë publikuar përmbajtje të përcjella me kërcënime eksplicite ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik nga mediat e përmendura.

Në kategorinë e sulmeve reale ndaj gazetarëve është regjistruar sulmi ndaj ekipit gazetaresk të MIA<sup>76</sup> gjatë raportimit për një protestë, kur disa persona kanë tentuar t'i marrin pajisjet e ekipit. Në fakt, gjatë protestave të një grupi qytetarësh për rastin “Monstra” më 26 shkurt 2021, ka pasur shtytje dhe tentim për marrjen e pajisjeve të anëtarëve të ekipit, gjatë së cilës kameramani është shtyrë dhe i është dëmtuar pajisja.

SHGM-ja, vitin e kaluar vazhdimisht ka reaguar ndaj paraqitjeve të papërshtatshme dhe të papranueshme të funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar<sup>77</sup>, duke theksuar se me këtë e cenon integritetin e gjithë profesionit të gazetarisë dhe se funksionarët publikë, veçanërisht liderët e partive politike, si dhe bartësit e funksioneve të tjera publike, duhet të përmbahen nga deklaratat që mund të kuptohen si etiketim gazetarësh dhe medias, pasi kjo cenon vlerat demokratike dhe lirinë e profesionit të gazetarisë.

Në vitin 2021, ishte ende i pranishëm trendi i dekurajimit të gazetarëve për denoncimin e sulmeve. Sidomos shqetësim i veçantë është numri në rritje i sulmeve online ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik.

72 SHGM, “Dënojmë përpjekjet për diskreditimin e gazetares Xhumadije Ibraimi nga TV Klan”, Shkup, 2021. Qasur prej dt. 5.12.2021 <https://bit.ly/3KBVMKS>

73 SHGM, “Ankesa në KSHZ dhe MPB për pengimin e punës së gazetares Ferikan Arifi”, Shkup, 2021. Qasur prej dt. 7.12.2021 <https://bit.ly/3rNGBFm>

74 SHGM, “Dënojmë sjelljen poshtëruese të kandidatit Fatmir Limani ndaj gazetares Salije Sadiku nga TV 21”, Shkup, 2021. Qasur më dt. 10.12.2021 <https://bit.ly/3FXtNS2>

75 SHGM, “Është pozitive që MPB mori masa, tani presim edhe zgjidhje gjyqësore për kërcënimet ndaj gazetarëve”, Shkup, 2021 <https://bit.ly/3FQvxfD>

76 SHGM, “Dënojmë ashpër sulmin ndaj ekipit gazetaresk të MIA”, Shkup, 2021. Qasur më dt. 20.12.2021 <https://bit.ly/356E80D>

77 SHGM, “SHGM i bën thirrje Kryetarit Merko që t'u kërkojë falje gazetarëve”, Shkup, 2021. <https://bit.ly/3K9sNNk>

Tabela 2. Numri i sulmeve të regjistruara ndaj gazetarëve në vitin 2021

Kategoritë	Numri	Përshkrimi
<p><b>Kërcënime dhe maltretime që nuk kanë të bëjnë me sigurinë fizike të gazetarëve</b></p> <p>Kjo kategori kërcënimesh dhe maltretimesh përfshinë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– mbikëqyrje ose ndjekje;</li> <li>– thirrje telefonike shqetësuese;</li> <li>– ngacim arbitrar gjyqësor ose administrativ;</li> <li>– deklarata agresive të nëpunësve publikë;</li> <li>– forma të tjera presioni që mund të rrezikojnë sigurinë e gazetarëve gjatë punës së tyre;</li> </ul> <p>Këto lloj kërcënimesh nuk përfshijnë mobingun dhe dhunën në ambientet e punës.</p>	3	<ul style="list-style-type: none"> <li>– Kërcënime dhe fyerje drejtuara ndaj gazetares Xhumadije Ibraimi nga TV Klan Maqedoni nga Vullnet Murseli Kërcënime</li> <li>– Ofendime drejtuar gazetares Ferikan Iljazi Arifit nga Euronews Shqipëri nga një anëtar i Këshillit Zgjedhor dhe përfaqësues i MPB-së</li> <li>– Kërcënime dhe ofendime ndaj Salije Sadikut nga TV 21 nga ana e Fatmir Limanit</li> </ul>
<p><b>Kërcënime për jetën dhe sigurinë fizike të gazetarëve</b></p> <p>Këto lloje kërcënimesh përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– kërcënime për vrasjen e gazetarëve, miqve të gazetarëve, anëtarëve të familjes së tyre ose burimeve të informacionit;</li> <li>– kërcënime me lëndime fizike ndaj gazetarëve, miqve të gazetarëve, familjarëve të tyre ose burimeve të informacionit;</li> </ul> <p>Këto kërcënime mund të jenë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– drejtpërdrejt ose nëpërmjet palëve të treta;</li> <li>– të dërguara në mënyrë elektronike ose drejtpërdrejt ballë për ballë;</li> <li>– implicite, por edhe eksplicite.</li> </ul>	1	<ul style="list-style-type: none"> <li>– Sulmi ndaj mediave dhe kërcënime ndaj një grupi gazetarësh të mediave: Pa censurë, TV 21, gazeta Express, Tetova Sot, Koha TV, Koha News, Kumanova Sot, TV Shenja dhe Lajmi Press nga Arben Esati.</li> </ul>
<p><b>Sulme reale ndaj gazetarëve</b></p> <p>Llojet e sulmeve reale ndaj gazetarëve mund të përfshijnë lëndime fizike ose mendore, rrëmbim, hyrje në shtëpi ose zyrë, pajisje të konfiskuara, ndalim arbitrar, përpjekje e dështuar për atentat dhe ngjashëm.</p>	1	<ul style="list-style-type: none"> <li>– Sulm ndaj ekipit gazetaresk të MIA gjatë raportimit për protestë dhe tentim për sekuestrim të pajisjeve nga qytetarët</li> </ul>
<p><b>Vrasje të gazetarëve</b></p> <p>Vrasje në shkëmbim zjarri, atentate, vrasje në shpërthim me bombë, rrahje për vdekje etj.</p>	0	
<p><b>Kërcënime dhe sulmet ndaj mediave dhe organizatave të lajmeve</b></p>	0	

## C2 Sjellja e institucioneve shtetërore dhe e aktorëve politikë ndaj mbrojtjes së gazetarëve

A ekzistojnë dispozita të veçanta në ligje apo mekanizma të tjerë që sigurojnë mbrojtjen e gazetarëve, offline dhe online?

Me ndryshimet dhe plotësimet e reja në Kodin Penal duhet të zgjerohet kompetenca e Prokurorisë për të vepruar sipas detyrës zyrtare për krimet që lidhen me sulmet dhe kërcënimet ndaj gazetarëve dhe të rriten dënimet për sulmuesit.<sup>78</sup> Propozimi nënkupton që sulmet ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik të ndiqen sipas detyrës zyrtare dhe jo me padi private si më parë (neni 14 i propozim-ndryshimeve që kanë të bëjnë me nenin 144 të Kodit Penal). Për Prokurorinë Themelore

Publike (PTHP) kjo do të jetë një rrethanë lehtësuese sepse mund t'i ndjekë autorët e sulmeve ndaj gazetarëve sipas detyrës zyrtare, por edhe zyrtarë të tjerë do të mund të ndiqen penalisht. Kjo është veçanërisht e rëndësishme sepse gazetarët rrallëherë vendosin vetë të padisin në rast të një sulmi fizik ose kërcënimi për jetën e tyre nga frika e pasojave nga autorët dhe autorët e sulmeve, si dhe nga kostot e larta financiare të zhvillimit të procedurës. Këto ndryshime dhe plotësime të ligjit janë ende në lexim të parë para deputetëve në Kuvend.

Në fund të vitit 2021, megjithatë, ka pasur një ndryshim pozitiv në punën e Gjyqësorit në lidhje me sigurinë e gazetarëve. Në gusht të vitit 2021, SHGM-ja ka parashtruar ankesë në Sektorin për Krime Kompjuterike dhe Forenzikë Digjitale pranë MPB-së për një koment të shkruar në mënyrë të papërshtatshme në faqen zyrtare të SHGM-së në Facebook, duke sulmuar të gjithë gazetarët, bazuar në një dispozitë të Kodit Penal që ndalon shpërndarjen materialit racist dhe ksenofobik me anë të një sistemi kompjuterik dhe nxitjen e urrejtjes, mosmarrëveshjes dhe intolancës në bazë të diskrimin-

<sup>78</sup> SHGM, "Rritje dramatike e sulmeve ndaj gazetarëve – kërkojmë zgjidhje urgjente", Shkup: 2020. Qasur më dt. 12.12.2021. <https://bit.ly/3fg9nbG>

imit nacional, racor, fetar dhe të tjera. Në kërkesën për procedurë penale të SHGM-së theksohej se përmbajtja e tillë nxit urrejtje shtesë ndaj gazetarëve, që mund të rezultojë me dhunë. Personi që ka shkruar këtë koment është dënuar me kusht për “përhapje të urrejtjes përmes sistemeve kompjuterike”.<sup>79</sup>

**A ekzistojnë mekanizma për monitorimin dhe raportimin për kërcënimet, ngacmimet dhe dhunën ndaj gazetarëve? A publikojnë institucionet shtetërore të dhëna të përditësuara për sulmet ndaj gazetarëve dhe për mosndëshkim?**

Ministria e Punëve të Brendshme ka një Regjistër të brendshëm të sulmeve ndaj gazetarëve, por ato të dhëna nuk i publikon publikisht, edhe përkundër faktit se SHGM-ja disa herë ka treguar për një nevojë të tillë. Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë mban një Regjistër gjithëpërfshirës dhe të detajuar të sulmeve dhe kërcënimeve ndaj gazetarëve, i cili përditësohet rregullisht dhe publikohet në ueb faqen e SHGM-së.<sup>80</sup>

**A ekzistojnë dokumente (protokolle, rregullore, etj.) të miratuara nga institucionet shtetërore që ofrojnë udhëzime dedikuar për ushtrinë dhe policinë, që ndalojnë maltretimin, frikësimin dhe sulmin fizik ndaj gazetarëve?**

Deri më tani, ushtria dhe policia nuk kanë miratuar dokumente të brendshme që i udhëzojnë pjesëtarët e tyre se si të trajtojnë gazetarët dhe që ndalojnë kërcënimet, frikësimet ose sulmet ndaj gazetarëve. Në vitin 2020, në kuadër të një projekti të zbatuar nga Qendra Ndërkombëtare për Parandalim dhe Luftë kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, SHGM-ja në bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme, kanë përgatitur dy dokumente: Udhëzimin për raportim profesional për ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin<sup>81</sup> dhe Protokollin për informim për raste që ndërlihen me ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin<sup>82</sup>.

**A bashkëpunojnë institucionet shtetërore me organizatat e gazetarëve për çështjet e tyre të sigurisë? A përmbahen institucionet shtetërore nga miratimi apo promovimi i kërcënimeve ndaj gazetarëve?**

Në vitin 2021, SHGM-ja bashkëpunoi me disa institucione shtetërore, të cilat treguan gatishmëri për t'u përfshirë në përmirësimin e sigurisë së gazetarëve dhe punonjësve mediatik. Përfaqësuesit e shoqatave të gazetarëve dhe të parlamenteve nga Maqedonia e Veriut, Serbia, Mali i Zi dhe Bosnja e Hercegovina nënshkruan një Deklaratë për avancimin e dialogut ndërmjet Parlamenteve dhe Shoqatave të Gazetarëve në Ballkanin Perëndimor. Ministria e Drejtësisë dhe SHGM-ja kanë pasur takime të rregullta vitin e kaluar për të punuar në amendamentet e disa ligjeve që janë kyçe për sigurinë dhe lirinë e gazetarëve.

*Për të përmirësuar sigurinë e gazetarëve dhe punonjësve mediatik, në shkurt të vitit 2021 u realizua një webinar si vazhdim i ngjarjes nga nëntori i vitit 2020 me temë: “Ndryshimet dhe plotësimet në Kodin Penal: Zgjidhje për të forcuar sigurinë e gazetarëve”. Në webinar morën pjesë tridhjetë pjesëmarrës, duke përfshirë: gazetarë/gazetare, ekspertë nga Këshilli i Evropës, përfaqësues/e të Prokurorisë Themelore Publike, një përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë, si dhe avokatë që përfaqësojnë gazetarët para gjykatave. Konkluzioni kryesor i ngjarjes ishte se vetëm përmes ndryshimeve konkrete në Kodin Penal, por edhe në Ligjin e procedurës Penale, duke zgjeruar kompetencën e Prokurorisë dhe të MPB-së për të vepruar sipas detyrës zyrtare dhe duke rritur dënimet për sulmuesit, do të përmirësohet në mënyrë sistematike siguria dhe politika e mosndëshkimit ndaj gazetarëve/gazetareve dhe punonjësve mediatik.*

**Në rastet e mbikëqyrjes elektronike, a e respektojnë institucionet shtetërore lirinë e shprehjes dhe privatësinë? Cili është rasti më i fundit i mbikëqyrjes elektronike ndaj gazetarëve?**

Përveç aferës së madhe të përgjimeve në vitin 2015, kur qindra gazetarë ishin në listën e përgjimeve të policisë sekrete, SHGM-ja nuk ka informacione se në vitin 2021 ndonjë gazetar ishte ekspozuar ndaj përgjimeve elektronike nga autoritetet. Para Gjykatës Themelore Civile – Shkup, 37 gazetarë kanë ngritur padi për dëmshpërblim për përgjimin e paautorizuar të komunikimeve të tyre në interval të caktuar kohor. Gazetarët e paditin Republikën e Maqedonisë së Veriut, përkatësisht Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Agjencinë për Siguri Kombëtare (ASK) si trashëgimtare juridike e ish-Drejtorisë së Sigurisë dhe Kundërzbulimit (DSK), e

79 SHGM, “Dënim me kusht për koment me gjuhë të urrejtjes shkruar në faqen e SHGM-së në Facebook”, Shkup, 2021. <https://bit.ly/3r0UeBA>

80 SHGM, “Mbrojtja sistematike e punonjësve mediatik është urgjentisht e nevojshme”, Shkup, 2021. Qasur me dt. 22.12.2021. <https://bit.ly/3Au0yoP>

81 Marina Tuneva, SHGM, “Udhëzim për raportim profesional për terrorizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm”, Shkup, 2021. <https://bit.ly/3j0ev5l>

82 Nikolla Dujovski, SHGM, “Protokoll për informim në raste që ndërlihen me terrorizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm”, Shkup, 2021. <https://bit.ly/3j4zCnM>

cila më parë ka funksionuar në kuadër të MPB-së. Në kontekst të kësaj padie, avokatët janë ende në pritje të vendimit të Gjykatës Penale të shkallës së dytë për vazhdimin e procedurës civile.

### **C3 Sjellja e sistemit gjyqësor civil dhe penal ndaj kërcënimeve dhe dhunës mbi gazetarët**

**A ekzistojnë departamente adekuate brenda gjykatave civile të dedikuara për hetimin dhe ndjekjen penale të kërcënimeve dhe akteve të dhunës ndaj gazetarëve?**

Gjykata Themelore Civile dhe Penale në Shkup, për të katërtin vit radhazi nuk është në gjendje të japë informacione të detajuara lidhur me fazën e procedurës për rastet në të cilat gazetarët janë palë në rast apo viktime të sulmeve. Arsyetimi i tyre është se sistemi i ri i menaxhimit të çështjeve (AKMIS) bazohet në kode jo në emra dhe profesione të palëve. Mirëpo, me kërkesë të SHGM-së, kjo gjykatë ka ofruar disa të dhëna për vitin 2021: se deri më 31 dhjetor 2021 ka pasur gjithsej njëzet raste aktive të shpifjes dhe fyerjes, në të cilat është paraqitur një gazetar apo media si palë.

**A ndanë Prokurori Publik apo Ministria e Punëve të Brendshme burime adekuate për zbatimin e hetimeve që kanë të bëjnë me kërcënimet dhe aktet e dhunës ndaj gazetarëve?**

Në sistemin gjyqësor-prokurorial në Maqedoni nuk ka departamente të veçanta që punojnë në hetime për rastet e sulmeve dhe kërcënimeve ndaj gazetarëve. Nuk zbatohen procedura të veçanta për rastet e sulmeve dhe kërcënimeve ndaj gazetarëve. Në anën tjetër, Gjyqësori dhe Prokuroria asnjëherë nuk janë ankuar në SHGM se rastet e gazetarëve nuk mund të trajtohen me efikasitet për shkak të mungesës së burimeve njerëzore apo materiale. Prandaj, SHGM-ja ka kërkuar që Prokuroria Themelore Publike të krijojë një Njësi speciale, e cila do t'i ndjek sulmuesit e gazetarëve. Kërkesa u arsyetua me qëndrimin se duhet të forcohen kapaciteti dhe efikasiteti i Prokurorisë Themelore Publike, sepse në vitet e fundit shumë rrallë që ky institucion të ngrinte aktakuzë kundër autorëve të sulmeve, kurse në rastet kur kishte ngritur hetime, ato ishin shumë të ngadaltë dhe joefikas.

Tradicionalisht, për të katërtin vit radhazi, Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë organizon manifestim për të shënuar 2 Nëntorin - Ditën Ndërkombëtare për ndërpre-

rjen e mosndëshkimit të krimeve kundër gazetarëve.<sup>83</sup> Me atë rast, para Prokurorisë Themelore Publike<sup>84</sup> u mbajt protestë paqësore dhe konferencë për media, të cilave iu drejtuan kryetari i Shoqatës, Mladen Cadikovski dhe kryetari i SPGPM -së, Pavle Belovski. Në fjalimet e tyre ata i kanë dërguar mesazhe opinionit dhe partive politike se gazetarët profesionistë nuk guxon dhe nuk duhet të sulmohen gjatë kryerjes së detyrës profesionale. Ata gjithashtu kërkuar nga Prokuroria Themelore Publike që menjëherë të ndjekë penalisht të gjitha sulmet dhe kërcënimet ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik dhe të formojë një Njësi speciale për ndjekjen penale të sulmuesve të gazetarëve, me theks të veçantë në rastet e pazbardhura të 27 prillit. Gjatë ndërrhyrjes në Kuvend të Republikës së Maqedonisë, një numër i madh i gazetarëve që pasqyruan ngjarjen në Kuvend janë sulmuar dhe lënduar.

**A sigurohen masat e duhura për të mbrojtur gazetarët kur është e nevojshme si përgjigje e kërcënimeve të mundshme për sigurinë e tyre fizike?**

Këtë vit nuk evidentojmë raste të sigurimit fizik nga MPB-ja për gazetarë të caktuar. Ndonëse përballen me frikë, gazetarët në përgjithësi nuk duan të kenë siguri fizike sepse kjo mund të ndikojë në punën e tyre të pavarur dhe në sigurimin e informacioneve të reja.

**A janë hetimet për krimet e gazetarëve, të cilat përfshijnë frikësimin dhe kërcënimin, në kohë, të pavarura dhe efektive?**

Sa i përket punës së institucioneve dhe zbardhjes së sulmeve ndaj gazetarëve, vërehet një mungesë e koordinimit dhe dobësi në komunikimin ndërinstitucional dhe më së shumti vërehet mes MPB-së dhe PTHP-së. Kjo ndikon që rastet, respektivisht hetimet të zgjasin shumë, edhe kur bëhet fjalë për raste të dukshme që mund të provohen lehtësisht. Rastet, në të cilat sulmohen gazetarët janë ende shumë vështirë për t'u arritur në një përfundim gjyqësor dhe rrallëherë arrihet deri tek nxitësit.

Numri i rasteve të zbardhura plotësisht të sulmeve ndaj gazetarëve është i vogël dhe kjo është shumë shqetësuese për sa i përket mosndëshkimit të autorëve. Ndërmjet 5 dhe 10 për qind e rasteve të regjistruara të shkeljes së të drejtave të gazetarëve që janë në regjistrin e sulmeve të SHGM-së në pesë vitet e fundit janë në pritje të vendimit të gjykatës.

<sup>83</sup> *Ibid.*

<sup>84</sup> SHGM dhe SPGPM, "Drejtesia selektive për 27 prill është padrejtësi për qytetarët dhe gazetarët", Shkup, 2021. <https://bit.ly/3JzG0z>

Më 29 dhjetor të vitit 2021 është miratuar aktgjykimi në favor të Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM) për rastin kur nga një profil në rrjetin sociale Facebook i emërtuar si “Sasho Mitev” është shkruar koment nën një postim të faqes së Facebook të SHGM-së.<sup>85</sup> Sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore Penale, Sasho Mitev është fajtor sipas nenit 394-g të Kodit Penal dhe dënohet me tre muaj burg për veprën penale “Përhapje e urrejtjes përmes sistemeve kompjuterike”, që nuk do të realizohet nëse nuk e kryen sërish veprën në afat prej një viti pas hyrjes në fuqi të aktgjykimit të kësaj vepre. Ky është shembulli i parë i Gjykatës dhe Prokurorisë që përfundojnë një procedurë plotësisht për kërcënim-online ndaj gazetarëve.

Në dhjetor të vitit 2020, Gjykata Themelore Civile në Shkup ka miratuar aktgjykim me të cilin refuzohen kërkesat paditëse të gazetarëve Natasha Stojanovska dhe Dushica Mërgja, të cilat kërkuan kompensim nga shteti për shkeljen e të drejtave të tyre gjatë ngjarjeve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut nga 27 prilli 2017. Këto padi janë ngritur në kuadër të ndihmës juridike të ofruar nga SHGM-ja për gazetarët dhe punonjësit mediatik të cilët janë sulmuar ose janë shkatërruar pajisjet e tyre gjatë ngjarjes. SHGM-ja e vlerësoi këtë aktgjykim si tregues të zbatimit të standardeve të dyfishta nga gjykata, kur është fjala për politikanë dhe gazetarë. Në rastin me një grup të politikaneve Prokuroria Themelore Publike sipas detyrës zyrtare ka nisur procedurën dhe Gjykata Penale ka dënuar me burgim një grup qytetarësh, ndërsa gazetarët e sulmuar duhet të bëjnë padi private. Në arsyetimin e Gjykatës thuhet se gazetarët nuk kanë dorëzuar prova të mjaftueshme për të vërtetuar se më 27 prill 2017 ka pasur protesta publike para Kuvendit, ndonëse në padi kanë dorëzuar video-filmime, si dhe ka një numër të madh të kronikave gazetareske të mediave nga dita kritike.

Në takimet me MPB-në<sup>86</sup>, SHGM-ja vazhdimisht ka insistuar në hetime më të shpejta dhe më efikase të sulmeve ndaj gazetarëve, por edhe në përmirësimin e kushteve të punës së gazetarëve dhe punonjësve mediatik gjatë raportimit nga hapësirat e këtij institucioni. Me sugjerimin e SHGM-së, si dhe pas konstatimit të mangësive në raportet e institucioneve ndërkombëtare, Ministria e Punëve të Brendshme filloi të mbajë evidencë për sulmet ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik. SHGM-ja me Avokatin e Popullit, në maj të vitit 2019 nënshkruan Memorandumin e Bashkëpunimit, përmes të cilit të dyja institucionet u angazhuan që në të ardhmen të

punojnë në mënyrë aktive për çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë e gazetarëve.

Në kontekst të dënimit të dhunës ndaj gazetarëve dhe thirrjeve për zbardhje më të shpejtë të këtyre sulmeve, Komisioni Evropian në raportin vjetor për progresin e RMV-së në vitin 2021 e trajtoi sërish çështjen e sigurisë dhe frikësimit të gazetarëve dhe rekomandoi: “Në këtë pjesë është e nevojshme të zbatohet një qasje e tolerancës zero ndaj frikësimit, kërcënimit dhe akteve të dhunës ndaj gazetarëve në ushtrimin e profesionit të tyre dhe të sigurohet që autorët të sillen para drejtësisë. Rastet e dhunës fizike dhe verbale dhe kërcënimeve ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik janë shtuar, ndërsa kushtet e tyre të punës, veçanërisht të drejtat e punëtorëve dhe ato sociale, mbeten të vështira.”<sup>87</sup> Në Raport rekomandohet edhe organet e zbatimit të ligjit dhe Prokuroria Publike të ndjekin incidentet me gazetarët, por se nevojitet një koordinim më i mirë ndërmjet institucioneve të ndryshme për të vepruar më shpejt ndaj shkeljeve të raportuara dhe për të parandaluar mosndëshkimin e autorëve.<sup>88</sup>

**A siguron shteti trajnime adekuate për policinë, prokurorët, avokatët dhe gjyqtarët për mbrojtjen e lirisë së shprehjes dhe gazetarët? A i organizojnë këto trajnime në bashkëpunim me shoqatat e gazetarëve?**

Akademia për Trajnime të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë, në bashkëpunim me SHGM-në, ka vazhduar të zhvillojë trajnime me gazetarë dhe përfaqësues të gjyqësorit edhe në vitin 2021 dhe, po ashtu, dhe tema që kanë të bëjnë me lirinë e shprehjes janë pjesë e kurrikulës së rregullt të trajnimeve të Akademisë të dedikuara për gjyqtarë dhe prokurorë.

Sa i përket bashkëpunimit me institucionet, SHGM-ja vitin e kaluar ka qenë në komunikim dhe ka mbajtur takime konsultative pothuajse me të gjitha institucionet që duhet të garantojnë sigurinë e gazetarëve, përfshirë kryetarët e Prokurorisë Themelore Publike, Gjykatës Themelore Penale dhe Gjykatës Themelore Civile, Gjykatën Kushtetuese dhe Ministrinë e Drejtësisë.<sup>89</sup> Me qëllim të uljes së përqindjes së mosndëshkimit për sulmet ndaj gazetarëve, SHGM-ja ka bashkëpunuar dhe ka

85 SHGM, “Dënim me kusht për koment me gjuhë të urrejtjes shkruar në faqen e SHGM-së në Facebook”, Shkup, 2021. <https://bit.ly/3ZloOk>

86 SHGM, “Seksioni i kameramanëve pranë SHGM-së në takim në MPB”, Shkup, 2019. Qasur më dt. 22.1.2022. <https://bit.ly/35Hsvvv>

87 Komisioni Evropian, “Raport për Maqedoninë e Veriut për vitin 2021”, Strasburg, 2021. Qasur më dt. 2.2.2022. <https://www.sep.gov.mk/data/file/Pregovori/North-Macedonia-Report-2021-%D0%9C%D0%9A2.pdf>

88 Komisioni Evropian, “Raport i Komisionit Evropian për Maqedoninë e Veriut për vitin 2020”, Bruksel, 2020. Qasur më dt. 15.11.2020. <https://www.sep.gov.mk/post/?id=5657#YAGhuthKjIU>

89 SHGM, “SHGM me iniciativë për bashkëpunim ndër-sektorial për të përmirësuar sigurinë e gazetarëve”, Shkup, 2021. Qasur më dt. 26.01.2022. <https://bit.ly/3J0hXbe>



mbajtur takime edhe me Prokurorin Publik të Shtetit.<sup>90</sup> Në këto takime u ngritën disa çështje që kanë të bëjnë me përmirësimin e sigurisë së gazetarëve dhe punonjësve mediatik dhe efikasitetin e Prokurorisë Themelore Publike në ndjekjen penale të atyre që kërcënojnë gazetaret dhe shkelin të drejtat e tyre. Gjithashtu u thek-

sua nevoja për organizimin e trajnimeve dhe punëtorive të përbashkëta për gazetarë, gjyqtarë dhe prokurorë, me qëllim të përmirësimit të raportimit të gazetarëve dhe sjelljes së prokurorëve në rastet që kanë të bëjnë me lirinë e fjalës.

90 SHGM, "SHGM-ja kërkon Njësi të posaçme për zgjidhjen e sulmeve ndaj gazetarëve", Shkup, 2020. Qasur prej dt. 10.10.2020. <https://bit.ly/3bs0Ot6>

Tabela 3. Pasqyrë e rasteve më serioze të kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve në 5 vitet e kaluara

	Viti 2017.	2018.	2019.	2020.	2021.
<b>Rasti</b>					
<b>Ekipi gazetares i MIA</b> Sulmi ndaj ekipit gazetaresk gjatë raportimit nga protesta dhe tentim për marrje të pajisjes					An attempt to seize the equipment and push, during which the camera operator was pushed and his equipment was damaged. Citizens carried out the attack, a report was submitted to the Ministry of Interior for the attack, there is no solution.
<b>Ekipet gazetareske nga mediat</b> Pa censurë, TV 21, Gazeta Express, Tetova Sot, Koha TV, Koha News, Kumanova Sot, TV Shenja dhe Lajmi Press.					Threats to life and attack on media and threats to journalists. The case was reported to the Ministry of Interior, which submitted a notification to AJM that criminal charges had been filed against the person, waiting for the Public Prosecutor to act upon the report.
<b>Ekipi gazetaresk i TV 21</b> Pas incizimit të kronikës televizive për ankesat e banorëve të Komunës së Haraçinës për infrastrukturën e keqe, familjarët e kryetares Milikije Halimi kanë kërcënuar verbalisht se do t'ua thyejnë kamerën dhe kanë kërkuar që të fshihen incizimet.					Rasti nuk është denoncuar në polici, por SHGM-ja vazhdimisht i ka bërë thirrje policisë dhe Prokurorisë Publike që të hapin hetime. Megjithatë, Prokuroria vendosi të mos veprojë sipas zërit të dëgjuar.

	Viti 2017.	2018.	2019.	2020.	2021.
<b>Rasti</b>					
<b>Naser Selmani</b> Gazetari dhe ish- kryetari i SHGM-së ka marrë mesazh me kërcënim me vdekje nga Bejtulla Asani, vëllai i Beqir Asanit, i cili është i lidhur me partinë politike në pushtet, BDI.		Rasti është denoncuar në polici, kurse Prokuroria ka hapur hetim. Deri më tani janë thirrur të japin deklaratë edhe Naser Selmani edhe kërcënuesi.	Rasti vijon para Prokurorisë Themelore Publike.		
<b>Armand Braho</b> Banditë të partisë Aleanca për Shqiptarët e kanë sulmuar gazetarin Armand Braho gjatë një konference në të cilën ai ka qenë i ftuar me thirrje të rregullt.		Rasti është denoncuar në polici. Gjykata i ka dënuar sulmuesit me gjoba në të holla.			
<b>Grup i gazetarëve</b> Shumë gazetarë dhe punonjës mediatik ishin sulmuar nga turma që dhunshëm hynë në Parlament më 27.04.2017.	Rasti është denoncuar në polici. Prokuroria nuk ka ndër marrë asnjë veprim.	Prokuroria i ndjekë personat që kanë sulmuar politikanë kurse nuk i ndjekë personat që i sulmuan gazetarët dhe punonjësit mediatik.	Avokatët e SHGM-së përfaqësojnë 7 gazetarë dhe në emrin e tyre do të parashtrijnë 4 padi të cilat 3 janë veçmas dhe një padi është grupore për 3 gazetarë.		AJM lawyers are awaiting a second instance verdict from the Criminal Court to continue the civil proceedings.
<b>Vladimir Zhelçeski dhe Aleksandar Todorov</b> Dy gazetarët, duke raportuar për protestën e madhe "Për Maqedoni të përbashkët", janë sulmuar fizikisht nga persona të panjohur – pjesëmarrës në protestë, pasi nuk i përkëtuar medias pro-qeveritare. Ata janë goditur disa herë, si pasojë kanë pësuar lëndime trupore dhe më pas janë mbajtur në spital për 24 orë.	Rasti është denoncuar në polici dhe Prokuroria Publike ka hapur hetim.	Gjykata shqiptoi dënim me burg prej 6 muajve për sulmuesit.			
<b>Meri Jordanovska</b> Emil Jakimovski ka kërcënuar dhe ofenduar gazetaren dhe zëvendës-redaktoren e portalit A1on, Meri Jordanovska. Sipas mesazheve të publikuara nga Jordanovska, kërcënuesi e ka ofenduar fjalë fyese, duke e kërcënuar se "do t'i krijonte nekrologji".				Propozim-aktakuzë për vepër penale kërcënim i sigurisë, për mesazhet kërcënuese të dërguara përmes rrjetit sociale Telegram. Aktgjykimi nr. 212/20 i dt. 16.02.2020, me të cilin është dënuar me dënim me burg në kohëzgjatje prej 1 viti dhe 8 muaj Kundër aktgjykimit është parashtruar ankesë, por ankesa është refuzuar dhe aktgjykimi është konfirmuar nga gjykata e shkallës së dytë.	

# Konkluzione dhe rekomandime

## Konkluzione

Në vitin 2021 është bërë një hap pozitiv sepse u hartuan ndryshimet dhe plotësimet në Ligjin për përgjegjësinë civile për fyerje dhe shpifje dhe në Kodin Penal. Pothuajse të gjitha vërejtjet e SHGM-së për zvogëlimin e shumës së kompensimit për dëmin jo-material në rast të fajësisë së gazetarit dhe plotësimin e pjesëve për përjashtimin nga përgjegjësia për shpifje dhe fyerje janë pranuar. Me ndryshimet dhe plotësimet në Kodin Penal, të iniciuara nga SHGM-ja dhe sindikata e gazetarëve, u inkorporuan kërkesat për mbrojtje sistematike të gazetarëve dhe punonjësve mediatik, ku sulmi ndaj gazetarit dhe punonjësit mediatik do të trajtohet si sulm ndaj një personi zyrtar, që do të thotë se PTHP-ja do të veprojë sipas detyrës zyrtare, kurse dënimet për sulmuesit do të rriten.

Çështja shqetësuese nga aspekti i mbrojtjes së pluralizmit politik është reklamimi i paguar politik, që nuk ndalohet shprehimisht në periudhën jashtë zgjedhjeve dhe gjatë fushatës zgjedhore mbulohet me mjete nga Buxheti. Qëndrimi i SHGM-së është që reklamimi i paguar politik në media duhet të hiqet në çdo kohë sepse në këtë mënyrë “blihen” pronarët e mediave, kjo praktikë ndikon negativisht në politikën redaktuese të mediave dhe “zhvendoset” bilanci i pikëpamjeve të ndryshme në sferën publike. SHGM-ja kundërshtoi edhe ndryshimet e mundshme të Ligjit për shërbimet mediatike audio dhe audiovizuale, me të cilat do të mundësohej reklamimi i institucioneve publike në mediat audiovizuale. Kjo do ta sillte situatën në industrinë e medias në nivelin e pesë viteve më parë, kur shuma astronomike paguheshin në media në mënyrë jo transparente me fonde shtetërore pa asnjë kriter. Reformat në servisin radiodifuziv

publik vështirë se kanë filluar, kurse pavarësia financiare dhe qëndrueshmëria e radiodifuzerin publik mbeten një çështje e hapur. Është veçanërisht e rëndësishme gjetja e zgjidhjeve për borxhet e vjetra të radiodifuzerin publik ndaj institucioneve shtetërore.

Vlerësim i përgjithshëm është se në vitin 2021, pozita socio-ekonomike e gazetarëve u përkeqësua edhe më shumë për shkak të pandemisë, përkatësisht për shkak të uljes së të ardhurave nga reklamat në të gjithë sektorin mediatik. Statusi i punësimit të shumë gazetarëve, veçanërisht në mediat private, është i pasigurt, pasi gazetarët përgjithësisht kanë kontrata me kohë të caktuar ose kontrata honorare, nuk u paguhen kontributet për sigurim pensional dhe social, kanë të ardhura të ulëta dhe nuk u respektohen të drejtat e tjera të punës. Prandaj, gazetarët janë shumë më të prekshëm ndaj presioneve, si nga strukturat drejtuese ashtu edhe nga pronarët dhe politikanët. Presionet janë zakonisht suptile dhe pak të dukshme, gazetarët përmbahen nga të folurit hapur për këto fenomene dhe rrallëherë denoncojnë kur shkelen të drejtat e tyre themelore. Edhe pse vlerësohet se gazetarët në redaksi, në përgjithësi, kanë më shumë liri, ende ka shumë ndikime në punën e përditshme që nuk janë edhe aq të dukshme, respektivisht ka më shumë auto-censurë sesa presion të drejtpërdrejtë. Pozicioni i gazetarëve në mediat lokale dhe rajonale është më keq, sepse këto media janë në gjendje të keqe financiare dhe përveç kësaj, në zona të vogla, pushtetarët lokalë mund të bëjnë lehtësisht presion. Statusi i punës dhe pozicioni i grave gazetare në redaksi nuk ndryshon shumë nga ai i kolegeve të tyre gazetarë, me përjashtim të faktit se ka më pak gra në poste drejtuese në media.

Në vitin 2021, numri i sulmeve ndaj gazetarëve është zvogëluar. Por, megjithëse numri i kërcënimeve verbale dhe fizike është në rënie, fakti që gazetarët dhe profesionistët mediatik janë gjithnjë e më shumë subjekt i kërcënimeve dhe ngacmimeve në rrjetet sociale, prej të cilave një pjesë ishin kërcënime serioze për sigurinë

fizike të gazetarëve që punojnë në hulumtimin e korrupsionit dhe fenomeneve të tjera negative shoqërore. Është e rëndësishme të theksohet se në dhjetor të vitit 2021 është miratuar një aktgjykim në favor të Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM) për kërcënim online ndaj të gjithë gazetarëve të shkruar në faqen e SHGM-së në Facebook. Ky është shembulli i parë që Prokuroria dhe Gjykata hetojnë dhe sanksionojnë një kërcënim serioz online ndaj gazetarëve. Problem i madh është ende mosndëshkimi, pasi institucionet kompetente nuk bashkëpunojnë sa duhet dhe rrallëherë ngrënë aktakuza kundër autorëve të kërcënimeve apo sulmeve, ndërsa në rastet kur iniciohen hetime ato zhvillohen ngadalë dhe në mënyrë joefikase. Me shqetësim të veçantë është gjuha e urrejtjes dhe etiketimi i gazetarëve dhe punonjësve të medias nga politikanët dhe zyrtarët e tjerë publikë. Gjithashtu, institucionet kompetente dhe gjykatat ende nuk mbajnë shënime të përditësuara sa duhet për kërcënimet dhe sulmet ndaj gazetarëve dhe as nuk publikojnë të dhëna të tilla. Megjithatë, është pozitive që institucionet kompetente janë të hapura për bashkëpunim me SHGM-në dhe përmes konsultimeve të përbashkëta tregojnë gatishmëri për të punuar në përmirësimin e sigurisë së gazetarëve dhe punonjësve të mediatik duke marrë masa më me kohë dhe duke i ndjekur penalisht autorët e sulmeve dhe kërcënimeve.

#### Rekomandime

Ndërhyrje ligjore dhe përmirësim të implementimit të ligjeve:

- Zbatimi i procedurës për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të ASHMAA dhe Këshillit Programor të RTM-së nga Kuvendi i RMV-së. Procedura duhet të zhvillohet në mënyrë transparente, me dëgjim publik të të gjithë kandidatëve, ndërsa parimi i shumicës prej dy të tretash duhet të ruhet në vendimmarrjen e Kuvendit.

- Është e nevojshme të analizohen dispozitat e Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale dhe ligjeve të tjera përkatëse në drejtim të përmirësimit të gjendjes financiare të mediave private dhe vendosjes së mekanizmave për lehtësim tatimor dhe përfitime të ngjashme për mediat.
- Është e nevojshme të hapet një debat për krijimin e mundshëm të një fondi për mediat, veçanërisht për qëllimet dhe kriteret e mbështetjes financiare (nxitja e diversitetit programor, përmirësimi i statusit të gazetarëve etj.), mënyrën e shpërndarjes së fondëve, pavarësinë dhe objektivitetin në zbatimin e procedurës.
- Nevojiten ndryshime dhe plotësime në Kodin Zgjedhor për të thjeshtuar rregullat për fushatën mediatike dhe për të reduktuar mundësinë e keqpërdorimit të reklamimit të paguar politik në mediat private.
- Inicimi i ndryshimit dhe plotësimit të Kodit Etik të Gazetarëve në servis publik RTM për të forcuar vetë-rregullimin e brendshëm në këtë medium.
- Krijimi i regjistrave të posaçëm për rastet e padive kundër gazetarëve, në kuadër të gjykatave themelore civile dhe penale, përfshirë edhe PTHP-në.
- Zbatimi efikas i ligjeve për siguri më të mirë të gazetarëve dhe punonjësve mediatik.
- Proces i vazhdueshëm në ngritjen e kapaciteteve të gazetarëve, avokatëve, gjyqtarëve dhe prokurorëve për temat që kanë të bëjnë me sanksionimin e sulmeve ndaj gazetarëve dhe interpretimin e përgjithshëm të nenit 10 të GJEDNJ.
- Përmirësimi i bashkëpunimit me përfaqësuesit e sapozgjedhur të Kuvendit të RMV-së për temat që kanë të bëjnë me lirinë e shprehjes dhe politikat mediatike.
- Vazhdimi i lobimit të SHGM-së për vendosjen e protokolleve dhe avancimin e procedurave të brendshme në institucione, me qëllim parandalimin e dhunës ndaj gazetarëve dhe sanksionimin efektiv të saj.
- Në bashkëpunim dhe përkrahje me Misionin e OSBE-së në Shkup, të përmirësohet bashkëpunimi me Avokatin e Popullit, me qëllim të rritjes së bashkëpunimit ndërmjet SHGM-së dhe institucionit në mbrojtjen e të drejtave të gazetarëve.

Përmirësimi i sigurisë së gazetarëve:

- Votimi në Kuvend i ndryshimeve dhe plotësimeve në Kodin Penal në dy drejtime: 1) Ndryshimi dhe plotësimi i dispozitave që përcaktojnë gjuhën e urrejtjes në përputhje me praktikën e GJEDNJ dhe 2) Ndryshimi dhe plotësimi në pjesën e autorizimeve të PTHP-së për të vepruar sipas detyrës zyrtare gjatë sulmit ndaj gazetarit dhe/ose punonjësit të medias, si dhe parashikimi i dënimeve më të larta për shkelësit, si dhe votimi dhe miratimi i ndryshimeve dhe plotësimeve të Ligjit për përgjegjësinë civile për shpifje dhe fyerje, që redukton dëmin jomaterial të gazetarëve.
- Formimi i një Njësie të re në PTHP-në, e cila do të jetë e ngarkuar vetëm për trajtimin e rasteve që kanë të bëjnë me shkeljen e të drejtave të gazetarëve dhe punonjësve mediatik, sigurinë e tyre, si dhe gjuhën e shprehur të urrejtjes ndaj tyre.

Përmirësimi i të drejtave të punës së gazetarëve:

- Vazhdimi i përpjekjeve të SPGPM-së, me mbështetjen e SHGM-së, për nënshkrimin e marrëveshjeve të reja kolektive me mediat private.
- Zbatimi i fushatave dhe trajnimeve, përmes të cilave gazetarët dhe mediat do të njiheshin më shumë me të drejtat e tyre elementare të punës.
- Të vazhdojë sigurimi i ndihmës juridike dhe shërbimeve këshillimore për gazetarët dhe punonjësit mediatik nga shoqatat esnafe të gazetarëve.
- Intensifikimi i bashkëpunimit dhe dialogut me institucionet në interes të mbrojtjes së të drejtave të punës së gazetarëve dhe punonjësve mediatik.





